

Veneto Banka Sh.A.

Pasqyrat Financiare sipas Standardeve
Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe
Raporti i Audituesit të Pavarur më dhe për vitin e
mbyllur më 31 dhjetor 2015

Përmbajtja

OPINIONI I AUDITUESIT.....	i
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE DHE TË ARDHURAVE TË TJERA	
GJITHËPËRFSHIRËSE.....	3
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL.....	5
PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE.....	6
1 Informacioni mbi Bankën.....	7
2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël.....	7
3 Menaxhimi i rrexikut fianciar.....	20
4 Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël.....	44
5 Adoptimi i standardeve të reja dhe interpretimet kontabël.....	45
6 Standardet e reja.....	46
7 Të ardhura nga interesi dhe të ngjashme.....	48
8 Shpenzime interesi dhe të ngjashme.....	48
9 Të ardhura neto nga tarifat dhe komisionet.....	48
10 Fitime neto nga transaksionet në monedhë të huaj.....	48
11 Të ardhura të tjera.....	49
12 Shpenzime për personelin.....	49
13 Shpenzime të përgjithshme të veprimtarisë.....	49
14 Shpenzimi i tatim fitimit.....	49
15. Mjete monetare dhe gjendje me Bankën Qëndrore.....	51
16. Rezerva e detyrueshme.....	52
17. Kredi dhe paradhënie për klientët.....	52
18 Instrumente financiare të vlefshme për shitje.....	53
19. Instrumente financiare të mbajtura deri në maturim.....	54
20 Aktive afatgjata jomateriale.....	55
21 Aktive afatgjata materiale.....	56
22 Aktive të tjera.....	57
23 Detyrime ndaj bankave.....	57
24 Detyrime ndaj klientëve.....	57
26 Detyrime të tjera.....	58
27 Kapitali aksionar dhe primi i aksioneve.....	58
28 Rezerva të tjera.....	59
29 Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre.....	59
30 Prezantimi i instrumentave financiarë sipas kategorisë së matjes.....	60
31 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara.....	60
32 Palët e lidhura.....	61
33 Ngjarje pas datës së Raportimit.....	62

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Bordi i Drejtorëve ne 31 dhjetor 2015

Flavio Trinca (Kryetar)
Alessandro Gallina (Anëtar)
Gaetano Caberlotto (Anëtar)
Innocente Nardi (Anëtar)
Gianfranco Ceruti (Anëtar)
Pierluigi Caferri (Drejt看 i përgjithshëm)

Zyrat e regjistruara

Blvd. Dëshmoret e Kombit
Kullat Binjake,
Tiranë, Shqipëri
Telefon: +355 4 2280 555
Faks: +355 4 2280 356

Audituesi

PricewaterhouseCoopers Audit Sh.p.k.
Rruga "Ibrahim Rugova"
Sky Tower, kati 9/1
Tiranë, Shqipëri
Telefon: +355 4 2242 254/280 423
Faks: +355 4 2241 639



Raport i audituesit të pavarur

Për Aksionarët dhe Bordin e Drejtorëve të Veneto Banka sh.a.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëlidhur të Veneto Banka sh.a. ("Banka") të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2015 dhe pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve në kapital dhe pasqyra e fluksit të parasë për vitin ushtrimor të mbyllur më këtë datë si dhe nga një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe informacion tjetër shpjegues.

Përgjegjësia e drejtimit për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon si të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të arritur sigurinë e arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar e evidencën e auditimit rreth shumave dhe shënimeve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rrezikut të anomalive materiale të pasqyrave financiare, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë kryerjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare me qëllim që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të njësisë ekonomike. Një auditim përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të kryera nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një paraqitje të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, të pozicionit financiar të Bankës më 31 dhjetor 2015, si dhe të performancës financiare dhe flukseve të parasë për vitin ushtrimor të mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.



Raport i audituesit të pavarur (vazhdim)

Çështje për t'u theksuar

Ne tërheqim vëmendjen në Shënimin shpjegues nr.4 të këtyre pasqyrave financiare, ku përshkruhen masat që Banka po merr për të adresuar çështjen e mjaftueshmërisë së kapitalit rregullator, si pasojë a historikut të humbjeve. Kjo, së bashku me faktorët e përmendur në Shënimin shpjegues 4, tregojnë ekzistencën e një pasigurie materiale që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme në lidhje me aftësinë e Bankës për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Opinioni ynë nuk është i kualifikuar në lidhje me këtë çështje.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.
PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.
30 qershor 2016
Tiranë, Shqipëri



Enida Cara

Auditues ligjor

Veneto Banka Sh.A.**Pasqyra e fitim humbjes dhe e të ardhurave gjithëpërfshirëse***(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur shpjegohet ndryshe)*

<i>në mijë Lekë</i>	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2014
Të ardhura nga interesi dhe të ngjashme	7	1,358,470	1,320,615
Shpenzime interesi dhe të ngjashme	8	(442,445)	(601,827)
Të ardhura neto nga interesi		916,025	718,788
Provizgjioni për zhvlerësimin e kredive dhe paradhënieve	17	(1,189,718)	(653,619)
Të ardhura neto nga interesi me klientët pas provigjionit për zhvlerësimin e kredive dhe paradhënieve me klientët		(273,693)	65,169
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet	9	166,292	122,385
Shpenzime për tarifat dhe komisionet	9	(45,287)	(29,306)
Të ardhura neto nga tarifat dhe komisionet		121,005	93,079
Fitime neto nga kurset e këmbimit	10	(92,088)	37,401
Të ardhura të tjera operative	11	744	74
Shpenzime personeli	12	(233,539)	(228,739)
Shpenzime administrative	13	(462,255)	(392,083)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	20,21	(104,029)	(96,352)
Fitimi para tatimit		(1,043,855)	(521,451)
Shpenzime tatim fitimi	14	5,256	4,785
Fitimi i vitit		(1,038,599)	(516,666)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:			
Instrumente financiare të vlefshme për shitje:			
- Fitimet minus humbjet gjatë vitit	18	(3,061)	(15,260)
- Tatimi fitimi i regjistruar në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		459	1,378
Të ardhura të tjera neto gjithëpërfshirëse gjatë vitit		(2,602)	(13,882)
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin		(1,041,201)	(530,548)

Pasqyrat financiare u miratuan nga Bordi i Drejtorëve, më 10 shkurt 2016 dhe u firmosën në emër të tij nga:

Pierluigi Caferri
Drejtor i Përgjithshëm

Florjan Bizhga
Përgjegjës i Departamentit
Financë Kontabilitet

Shënimet shpjeguese në faqet 7 deri 62 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Veneto Banka Sh.A.**Pasqyra e pozicionit financiar***(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur shpjegohet ndryshe)*


<i>në mijë Lekë</i>	Shënime	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Aktivët			
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	15	5,475,696	4,203,967
Rezerva e detyrueshme	16	1,979,069	1,883,999
Kredi dhe paradhënie për klientët	17	15,938,152	17,269,404
Instrumente financiare të vlefshme për shitje	18	568,936	2,132,071
Instrumente financiare të mbajtura deri në maturim	19	-	9,987
Aktive afatgjata jomateriale	20	48,308	48,329
Aktive afatgjata materiale	21	257,031	330,642
Tatim fitimi i parapaguar	14	33,379	27,073
Aktiv tatimor i shtyrë	14	15,847	10,132
Aktive të tjera	22	1,771,058	993,850
TOTALI I AKTIVEVE		26,087,476	26,909,454
Detyrimet			
Detyrime ndaj bankave	23	1,517,698	701,880
Detyrime ndaj klientëve	24	21,336,637	21,929,694
Detyrime të tjera	25	201,959	205,496
TOTALI I DETYRIMEVE		23,056,294	22,837,070
Kapitali			
Kapitali aksionar	26	4,661,307	4,661,307
Primi i aksioneve	26	70,069	70,069
Rezerva të tjera	27	19,277	21,879
Humbje e akumuluar		(1,719,471)	(680,871)
TOTALI I KAPITALIT		3,031,182	4,072,384
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		26,087,476	26,909,454

Pasqyrat financiare u miratuan nga Bordi i Drejtorëve, më 10 shkurt 2016 dhe u firmosën në emër të tij nga:

Pierluigi Caferri
Drejtore i Përgjithshëm



Florjan Bizhga
Përgjegjës i Departamentit
Financë Kontabilitet



Shënimet shpjeguese në faqet 7 deri 62 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Veneto Banka Sh.A.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur shpjegohet ndryshe)

<i>në mijë Lekë</i>	Kapitali aksionar	Primi i aksioneve	Humbje e akumuluar	Rezerva të tjera	Totali
Më 1 janar 2014	4,661,307	70,069	(164,205)	35,761	4,602,932
Fitimi i vitit	-	-	(516,666)	-	(516,666)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	(13,882)	(13,882)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	(516,666)	(13,882)	(530,548)
Më 31 dhjetor 2014	4,661,307	70,069	(680,871)	21,879	4,072,384
Më 1 janar 2015	4,661,307	70,069	(680,871)	21,879	4,072,384
Fitimi i vitit	-	-	(1,038,600)	-	(1,038,600)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	(2,602)	(2,602)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	(1,038,600)	(2,602)	(1,041,202)
Më 31 dhjetor 2015	4,661,307	70,069	(1,719,471)	19,277	3,031,182

Pasqyrat financiare u miratuan nga Bordi i Drejtorëve, më 10 shkurt 2016 dhe u firmosën në emër të tij nga:

Pierluigi Caferri
Drejtor i Përgjithshëm

Florjan Bizhga
Përgjegjës i Departamentit
Financë Kontabilitet

Shënimet shpjeguese në faqet 7 deri 62 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Veneto Banka Sh.A.**Pasqyra e flukseve monetare***(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur shpjegohet ndryshe)*

<i>në mijë Lekë</i>	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2014
FLUKSE MONETARE NGA AKTIVITETET OPERATIVE			
Fitimi para tatimit		(1,043,856)	(521,450)
Rregullime për:			
Zhvierësimin dhe amortizimin	20,21	104,029	96,352
Ndryshimet në provigjionin e kredive	17	1,189,718	653,619
Efekti i kurseve të këmbimit mbi mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre		24,722	-
Të ardhurat neto interesi dhe të ngjashme	7	(1,358,470)	(1,320,615)
Shpenzime interesi dhe të ngjashme	8	442,445	601,827
		(641,412)	(490,267)
Rritje e rezervës së detyrueshme me Bankën Qëndrore	28	(95,119)	(342,162)
Rritje e kredive dhe paradhënieve për klientët	17	(617,194)	(3,801,440)
Rritje në aktivet e tjera	22	3,047	(738,597)
Rritje në detyrimet ndaj bankave	23	143	(1,104)
Rritje në detyrimet ndaj klientëve	24	(490,907)	4,914,383
Rënie/(Rritje) në detyrimet e tjera	25	(3,537)	(17,416)
Interesa të arkëtuar		1,332,052	1,214,232
Interesa të paguar		(538,300)	(556,045)
Tatim fitimi i paguar		(6,305)	(25,222)
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet operative		(1,057,532)	156,362
FLUKSE MONETARE NGA AKTIVITETET INVESTUESE			
Blerje e instrumenteve financiare të vlefshme për shitje	18	-	(1,140,000)
Të arkëtuar nga shitja e instrumenteve financiare të vlefshme për shitje	18	1,565,000	700,000
Blerje e instrumenteve financiare të mbajtura deri në maturim	19	-	(10,000)
Të arkëtuar nga maturimi i instrumenteve financiare të mbajtura deri në maturim	19	10,000	75,590
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	21	(12,862)	(114,667)
Blerje e aktiveve afatgjata jomateriale	20	(17,535)	(40,887)
Paraja neto e përdorur nga aktivitetet investuese		1,544,603	(529,964)
FLUKSE MONETARE NGA AKTIVITETET FINANCUERE			
Arkëtime nga huadhënia		809,380	(300)
Paraja neto e përdorur nga aktivitetet financuese		809,380	(300)
Efekti i kurseve të këmbimit mbi mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre		(24,722)	-
Rënia neto në mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre		1,271,729	(373,902)
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në fillim të vitit	28	4,203,967	4,577,869
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në fund të vitit	28	5,475,696	4,203,967

Pasqyrat financiare u miratuan nga Bordi i Drejtorëve, më 10 Shkurt 2016 dhe u firmosën në emër të tij nga:

Pierluigi Caferri
Drejtore i Përgjithshëm

Florian Bizhga
Përgjegjës i Departamentit
Financë Kontabilitet

Shënimet shpjeguese në faqet 7 deri 62 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1 Informacioni mbi Bankën

Veneto Banka Sh.A. ("Banka") është një institucion bankar që kryen veprimtarinë e saj në Shqipëri në përputhje me dispozitat e Ligjit 9901, datë 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", dhe Ligjit 9662, datë 18 dhjetor 2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" i amenduar, si edhe me ligje të tjera të ngjashme. Sipas nenit 4 të statutit të saj, Banka ka si objekt të ekzekutojë për llogari të vetë apo për llogari të palëve të tjera, çdo veprimtari të njohur dhe të deleguar bankave nga ligji. Veneto Banka Sh.A. është themeluar dhe kryen aktivitetin e saj në Shqipëri. 100% të aksioneve të saj zotërohen nga Veneto Banca S.c.p.a. Itali, e cila është e vetmja shoqëria mëmë.

Aktiviteti kryesor i biznesit të Bankës janë veprimtaritë bankare tregtare dhe individuale në Republikën e Shqipërisë. Banka kryen veprimtarinë e saj në sajë të një license të plotë lëshuar nga Banka Qendrore e Republikës së Shqipërisë ("Banka e Shqipërisë" ose "BSH") që prej 11 janar 1999.

Banka ka 15 degë (2014:15) të cilat kryejnë aktivitetin brenda Republikës së Shqipërisë.

Adresa e regjistruar dhe selia e veprimtarisë. Adresa e regjistruar Bankës është në: Bulevardin "Dëshmorët e Kombit", Twin Towers, Tiranë, Shqipëri.

Monedha raportuese. Këto pasqyra financiare përgatiten në Lekë dhe të gjitha vlerat janë rrumbullakosur në mijëshen më të afërt (Lekë '000) përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 u autorizuan për publikim nga Bordi i Drejtorëve më 10 shkurt 2016. Miratimi i pasqyrave financiare nga aksionerët do të kryhet në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionerëve.

2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare paraqiten në vijim. Këto politika janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në gjithë vitet e mëparshme përveçse rasteve kur shprehet ndryshe.

2.1 Bazat e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") me parimin e kostos historike, modifikuar nga njohja fillestare dhe matja e instrumenteve financiarë të vlerësuar me vlerën e drejtë. Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë të paraqitura më poshtë.

Parimi i vijimësisë. Drejtimi ka përgatitur këto pasqyra financiare në bazën e parimit të vijimësisë. Referojuni Shënimit 4 për pasiguritë në lidhje me ngjarjet dhe kushtet të cilat mund të sjellin dyshime materiale mbi aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi.

2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme (vazhdim)**2.2 Konvertimi i monedhës së huaj**

Pasqyrat financiare paraqiten në Lekë Shqiptar, e cila është monedha funksionale dhe raportuese e Bankës.

Transaksione dhe gjendje

Transaksionet në valutë të huaj regjistrohen fillimisht në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivet dhe detyrimet monetare në valutë të huaj janë të rivlerësuar me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Të gjitha ndryshimet janë regjistruar si "(humbje)/fitime nga kurset e këmbimit" në fitim ose humbje. Zërat jo-monetarë që janë matur me kosto historike në monedhë të huaj përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datat fillestare të transaksioneve. Zërat jo-monetarë të matur me vlerë të drejtë në monedhë të huaj konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Kurset e këmbimit (Lekë për njësi të monedhës së huaj) të publikuara nga Banka e Shqipërisë për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 ishin si vijon:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
EUR	137.28	140.14
USD	125.79	115.23

2.3 Instrumentet financiare – njohja fillestare dhe matja e mëposhtme*a) Data e njohjes fillestare*

Blerjet ose shitjet e instrumenteve financiare të cilat kërkojnë që aktivi të dorëzohet brenda afatit kohor, zakonisht të përcaktuar nga rregulloret apo marrëveshjet në treg, njihen në datën e tregëtimit, psh. në datën kur Banka kryen blerjen ose shitjen e aktivit.

b) Njohja fillestare e instrumenteve financiarë

Klasifikimi i instrumenteve financiare në momentin e njohjes fillestare varet nga qëllimi për të cilin instrumentat financiarë janë blerë dhe karakteristikat e tyre. Të gjithë instrumentet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë të tyre plus, në rast të aktiveve dhe detyrimeve financiare jo me vlerën e drejtë përmes fitimit - humbjes, koston e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare është evidentuar më së miri me çmimin e transaksionit. Fitimi ose humbja neto në njohjen fillestare regjistrohet vetëm në qoftë se ka një ndryshim midis vlerës së drejtë dhe çmimit të transaksionit të cilat mund të vërtetohen me transaksione në të njëjtët instrumenta të tregut aktual ose nga një teknikë vlerësimi inputet e të cilit përfshijnë vetëm të dhëna nga tregje të mbikëqyrura. Banka i klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme: instrumente financiare të mbajtura deri në maturim, instrumente financiare të vlefshëm për shitje, huatë dhe llogaritë e arkëtueshme. Banka nuk ka klasifikuar asnjë aktiv financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit - humbjes.

2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme (vazhdim)

2.3 Instrumentet financiare – njohja fillestare dhe matja e mëpasshme (vazhdim)

c) Instrumente financiare të mbajtura deri në maturim

Nëse banka do të shiste një shumë jo të parëndësishme investimesh të mbajtura deri në maturim, e gjithë kategoria duhet të klasifikohet si të disponueshme për shitje. Instrumentet financiare të mbajtura deri në maturim maten më pas me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit, duke zbritur provigjionin e zhvlerësimit. Kosto e amortizuar llogaritet duke marrë parasysh çdo zbritje ose prim në blerje si edhe komisione të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Amortizimi përfshihet në "Të ardhura interesi dhe të ngjashme" në fitim ose humbje. Humbjet që rezultojnë nga zhvlerësimi i këtyre investimeve njihen në fitim ose humbje si "Humbje nga zhvlerësimi i instrumenteve financiare", nëse ka.

d) Instrumente financiare të vlefshme për shitje

Ky klasifikim përfshin investimet në letra me vlerë të cilat Banka ka për qëllim për ti mbajtur për një periudhë të pacaktuar kohe dhe të cilat mund të shiten në përgjigje të nevojave për likuiditet ose ndryshimeve në normat e interesit, kurset e këmbimit ose çmimet e kapitalit. Investimet në letra me vlerë të vlefshme për shitje mbahen me vlerën e drejtë. Të ardhurat nga interesi për letrat me vlerë të vlefshme për shitje llogaritet duke përdorur metodën e interesit efektiv, dhe njihet në rezultatin e vitit. Dividentët në instrumentet e ekuitetit të vlefshme për shitje njihen në rezultatin e vitit kur e drejta e Grupit për të marrë pagesa është themeluar dhe është e mundur që dividendët të mbledhen. Të gjitha elementet e tjera të ndryshimeve në vlerën e drejtë njihen në të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse deri në momentin që investimi çregjistrohet ose zhvlerësohet, dhe në njëjtën kohë fitimi - humbja e akumuluar riklasifikohet nga të ardhura të tjera gjithpërfshirëse në fitim - humbje për vitin. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në rezultatin e vitit kur kanë ndodhur si rezultat i një apo më shumë ngjarjeve ("ngjarjet e humbjeve") që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të investimeve në letrave me vlerë të vlefshme për shitje.

Një rënie e rëndësishme ose e zgjatur në vlerën e drejtë të një investimi në kapital nën koston e tij është një tregues që ai është i zhvlerësuar. Humbja kumulative nga zhvlerësimi - matur si diferenca midis kostos së blerjes dhe vlerës së drejtë aktuale, duke i zbritur humbje nga rënia në vlerë të aktivit të njohur më parë në rezultat, riklasifikohet nga të ardhura të tjera gjithpërfshirëse në rezultatin e vitit. Humbja nga zhvlerësimi i instrumenteve të kapitalit nuk kthehen dhe ndonjë fitim pasues njihet në të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse. Në qoftë se, në një periudhë të mëpasshme, vlera e drejtë e një instrumenti borxhi, klasifikuar si i vlefshëm për shitje, rritet dhe rritja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pasi humbja nga zhvlerësimi është njohur në rezultat, humbja nga zhvlerësimi anulohet nëpërmjet rezultatit të vitit.

2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme (vazhdim)

2.3 Instrumentet financiare – njohja fillestare dhe matja e mëpasshme (vazhdim)

e) Kredi dhe llogari të tjera të arkëtueshme

Kredi dhe te tjera të arkëtueshme përfshijnë "Kredi dhe parapagime Bankave" dhe "Kredi dhe parapagime Klienteve", të cilat janë asete financiare me pagesa fikse dhe të percaktuara dhe maturitete fikse që nuk janë kuotuar në tregjet aktive. Ata nuk kanë hyrë me qëllimin afatshkurter të rishitjes së menjeherëshme dhe nuk janë klasifikuar si "Asete Financiare të mbajtura për tregti", krijuar si "Investime Financiare të gatshme për shitje" ose "Asete Financiare krijuar me Vlerën e Drejte nepermjet Fitimit ose Humbjes. Pas matjes fillestare, vlerat e pagueshme ndaj bankave dhe kredive dhe parapagimet e klienteve janë si rrjedhime të matura me koston e amortizuar duke përdorur metodën e nivelit të interesit efektiv, minus provigjonet për zhvlerësim. Kosto e amortizuar llogaritet duke marrë parasysh çdo zbritje ose prim në blerje si edhe komisione të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Amortizimi përfshihet në "Të ardhura interesi dhe të ngjashme" në fitim ose humbje. Humbjet që rezultojnë nga zhvlerësimi i këtyre instrumenteve njihen në fitim ose humbje si "Humbje nga zhvlerësimi i kredive dhe paradhënies".

f) Detyrimet financiare

Pas matjes fillestare, borxhi dhe huamarrjet e tjera maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Nuk ka detyrime financiare të matura me vlerë të drejtë në fitim ose humbje. Çdo diferencë midis arkëtimit minus kostot e transaksionit dhe vlerës së riparimit njihet si "Shpenzime interesi dhe të ngjashme" në fitim ose humbje. Kosto e amortizuar llogaritet duke marrë parasysh çdo zbritje ose prim në emetim dhe kosto që janë pjesë integrale e normës efektive të interesit.

g) Kompensimi i instrumenteve financiare

Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur ekziston një e drejtë ligjore për të netuar shumat e njohura dhe ekziston synimi për shlyerje në baza kompensimi, ose për të realizuar aktivin apo shlyer detyrimin njëkohësisht.

h) Çregjistrimi

Instrumentet financiare çregjistrohen kur përfundojnë së ekzistuari të drejtat kontraktuale për të marrë flukse monetare nga aktivi, ose kur aktivi dhe të gjithë risqet dhe shpërblimet e pronësisë së tij janë transferuar (që domethënë, nëse të gjitha risqet dhe shpërblimet nuk janë transferuar tërësisht, banka teston kontrollin për t'u siguruar që përfshirja e vazhdueshme në bazë të të drejtave të mbetura nuk parandalon çregjistrimin).

2.4 Përcaktimi i vlerës së drejtë

Për instrumentet financiare që tregtohen në tregje aktive, përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare bazohet në çmimet e tregut ose kuotimet e çmimit nga ndërmjetësit. Një instrument financiar konsiderohet si i kuotuar në treg aktiv nëse çmimet e kuotuar janë të gatshme dhe rregullisht të publikuara në bursë, nga ndërmjetës, grupe industrish, shërbime çmimesh dhe agjenci rregullatore, dhe ato çmime paraqesin/përfaqësojnë transaksione të rregullta të vërteta që kryhen me vlera të drejta.

2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme (vazhdim)

2.4 Përcaktimi i vlerës së drejtë (vazhdim)

Nëse kriteret e mësipërme nuk përmbushen, tregu konsiderohet si jo-aktiv. Treguesit që tregu nuk është aktiv janë kur ka një hapësirë të madhe midis ofertës dhe kërkesës ose rritje të madhe në të apo kur ka pak transaksione kohët e fundit. Për të gjitha ato instrumente financiare që nuk janë të listuara në treg aktiv, vlera e drejtë përcaktohet duke përdorur metoda të përshtatshme vlerësimi. Metoda të tilla përfshijnë teknika të llogaritjes së vlerës aktuale, krahasimin me instrumente të ngjashëm për të cilët ekzistojnë çmime të publikuara dhe modele të tjera të përshtatshme.

2.5 Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Banka vlerëson nëse ka tregues objektiv zhvlerësimi në lidhje me një aktiv financiar ose një grup aktivesh financiare në çdo datë raportimi. Një aktiv financiar ose një grup aktivesh financiare supozohet se janë të zhvlerësuar nëse, dhe vetëm nëse, ekziston evidencë objektive zhvlerësimi si rezultat i një apo disa ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit (një 'ngjarje humbjeje') dhe që ngjarja (ose ngjarjet) ka një ndikim në vlerësimin e flukseve të ardhshme monetare nga aktiviteti financiar ose grupi i aktiveve financiare që mund të maten me besueshmëri.

Evidenca e zhvlerësimit mund të përfshijë tregues që huadhënësi ose një grup huadhënësisht po kalojnë vështirësi serioze financiare, paaftësi paguese ose vonesa në pagimin e interesave ose të principalit, mundësia që mund të kalojnë në likuidim ose riorganizim tjetër financiar dhe kur të dhëna të dukshme tregojnë se ka një rënie të matshme në vlerësimet e flukseve të ardhshme monetare, si ndryshimet në vonesa apo kushtet ekonomike që lidhen drejtpërdrejtë me paaftësinë paguese. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje për vitin kur kanë ndodhur si rezultat i një apo më shumë ngjarjeve ("ngjarje që çojnë në humbje") që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit financiar dhe të cilat kanë një ndikim në shumën apo kohën e flukseve të ardhshme monetare të vlerësuar të një aktiviteti financiar ose grup aktivesh financiare të cilat mund të vlerësohen me besueshmëri. Nëse Banka përcakton se nuk ka evidencë objektive që zhvlerësimi ka lindur për një aktiv financiar të vlerësuar individualisht, qoftë i rëndësishëm ose jo, ajo e përfshin aktivin në një grup aktivesh financiare me karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë, dhe kolektivisht vlerëson për zhvlerësimin e tyre. Faktorët kryesorë që Banka i konsideron në përcaktimin nëse një aktiv financiar është zhvlerësuar janë statusi i saj i vonuar dhe realizueshmërinë e kolateralit lidhur me këtë, nëse ka ndonjë. Kriteret e tjera kryesorë të mëposhtme janë përdorur gjithashtu për të përcaktuar nëse ka një evidencë objektive që një humbje nga zhvlerësimi ka ndodhur:

- një kështë është i vonuar dhe pagesa të vonuara nuk mund t'i atribuohet një vonese të shkaktuar nga sistemet e shlyerjes;
- huamarrësi ka një vështirësi të konsiderueshme financiare siç dëshmohet nga informacioni financiar i huamarrësit që Grupi ka;
- huamarrësi konsideron falimentimin ose një riorganizim financiar;
- ka një ndryshim negativ në statusin e pagesave të huamarrësit, si rezultat i ndryshimeve në kushtet ekonomike kombëtare ose lokale që ndikojnë tek huamarrësi; ose
- vlera e kolateralit ulet në mënyrë të konsiderueshme si pasojë e përkeqësimit të kushteve të tregut

Për qëllimet e vlerësimit kolektiv të zhvlerësimit, aktivet financiare grupohen në bazë të karakteristikave të ngjashme të rrezikut të kredisë. Këto karakteristika janë të rëndësishme për vlerësimin e flukseve të ardhshme të mjeteve monetare për grupe të tilla aktivesh, sepse janë tregues të aftësisë së debitorit për të paguar të gjitha shumat në përputhje me termat kontraktuale të aktiveve që janë të vlerësuar.

2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme (vazhdim)

2.5 Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

Flukset monetare të ardhshme në një grup aktiveve financiare, që janë të vlerësuara në mënyrë kolektive për zhvlerësim, vlerësohen në bazë të flukseve të mjeteve monetare kontraktuale të aktiveve dhe përvojën e menaxhimit në lidhje me nivelin në të cilën shumat do të bëhen të prapambetura si pasojë e ngjarjeve të kaluara të humbjes dhe suksesit të rimarrjes së shumave të prapambetura. Përvoja e kaluar është e rregulluar në bazë të të dhënave aktuale të mbikëqyrura për të pasqyruar efektet e kushteve aktuale, që nuk prekin periodat e kaluara, dhe për të hequr efektet e kushteve të kaluara që nuk ekzistojnë aktualisht.

Nëse kushtet e një aktivi të dëmtuar financiar të mbajtur me koston e amortizuar janë rinegociuar ose ndryshe modifikuar për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit ose emetuesit, zhvlerësimi matet duke përdorur normën fillestare të interesit efektiv përpara modifikimit të termave. Aktivi i rinegociuar regjistrohët dhe një aset i ri njihet me vlerën e tij të drejtë vetëm nëse rreziqet dhe përfitimet e aktivit kanë ndryshuar ndjeshëm. Kjo dëshmohet normalisht me një diferencë të konsiderueshme midis vlerave aktuale të flukseve të mjeteve monetare origjinale dhe flukseve të mjeteve të reja të mjeteve monetare të pritshme.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen gjithmonë përmes një llogarie zbritje për të zbritur vlerën kontabël neto të aktivit me vlerën aktuale të flukseve monetare të pritshme (të cilat përjashtojnë humbjet e ardhshme të kredisë që nuk kanë ndodhur), të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv të aktivit. Llogaritja e vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare të një aktivi financiar të kolateralizuar pasqyron flukset monetare që mund të rezultojë nga konfiskimi minus kostot për përftimin dhe shitjen e kolateralit, nëse është apo jo i mundshëm.

Nëse, në një periudhë të mëpasshme, shumat e humbjes nga zhvlerësimi ulet dhe kjo ulje mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pasi është njohur zhvlerësimi (siç është përmirësimi i klasifikimit kreditues të borxhmarrësit), humbja nga zhvlerësimi e njohur më parë kthehet mbrapsht duke bërë rregullimin e llogarisë së zbritjes përmes fitimit ose humbjes për vitin.

Pasuritë e pambledhshme fshihen duke marrë pasqyrat humbjen nga provigjioni pasi të gjitha procedurat e nevojshme për të rimarrë aktivin kanë përfunduar dhe shumat e humbjes është përcaktuar. Rikuperimet pasuese të shumave të fshira më parë kreditohen në llogarinë e humbjes nga provigjioni në fitim ose humbje për vitin.

a) Kreditë dhe paradhëniet për bankat dhe klientët

Për detyrimet ndaj bankave dhe kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve të mbajtura me kosto të amortizuar, Banka vlerëson fillimisht nëse ekziston evidencë zhvlerësimi për instrumente financiare të cilat janë individualisht të rëndësishme, ose kolektivisht për instrumente financiare që nuk janë individualisht të rëndësishëm. Nëse banka përcakton se nuk ka evidencë objektive zhvlerësimi për aktivet e vlerësuara individualisht, të rëndësishëm ose jo, ajo e përfshin aktivin në një grup aktiveve financiare me karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë dhe vlerëson në mënyrë kolektive zhvlerësimin për to. Aktivet që vlerësohen individualisht për zhvlerësim dhe për të cilat ka ndodhur një humbje zhvlerësimi, ose vazhdon të njihet, nuk përfshihen në vlerësimin kolektiv për zhvlerësim. Nëse ekziston evidencë objektive që ka ndodhur një humbje zhvlerësimi, shumat e humbjes matet si diferencë midis vlerës kontabël të aktivit dhe vlerës aktuale të vlerësimit të flukseve monetare të ardhshme. (duke përjashtuar humbjet e pritshme të kredisë të cilat nuk kanë ndodhur ende).

2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme (vazhdim)

2.5 Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

a) Kreditë dhe paradhëniet për bankat dhe klientët

Vlera e mbetur e aktivitetit reduktohet me përdorimin e llogarisë së provigjionit dhe kjo shumë njihet në fitim ose humbje. Kreditë së bashku me provigjionin përkatës regjistrohen kur nuk parashikohen rimarrje të ardhshme reale dhe i gjithë kolaterali është realizuar ose i është transferuar bankës. Nëse, në një vit të mëpasshëm, shumat e vlerësuar e humbjes së zhvlerësimit rritet si pasojë e një ngjarjeje të ndodhur pas njohjes së zhvlerësimit, humbja e zhvlerësimit e njohur më parë rritet ose zvogëlohet në llogarinë e provigjionit. Kur rimerret një regjistrim i mëparshëm, rimarrja kreditohet në "Provigjion nga zhvlerësi i kredive dhe paradhënieve".

Vlera aktuale e vlerësimeve të flukseve të ardhshme monetare skontohej me normën efektive të interesit fillestare të aktiveve financiare. Nëse një kredi ka një interes të ndryshueshëm, norma e skontimit për matjen e humbjeve të zhvlerësimit është norma aktuale e interesit. Për llogaritja e vlerësimit të flukseve të ardhshme të një aktivi financiar me kolateral pasqyron flukset monetare që mund të rezultojnë nga marrja e kolateralit minus kostot e marrjes dhe shitjes së tij, qoftë marrja e mundshme ose jo.

Me qëllim vlerësimin e zhvlerësimit kolekti, aktivet financiare grupohen në bazë të sistemit të brendshëm të Bankës për rrezikun e kredisë, i cili merr parasysh karakteristikat e rrezikut të kredisë, të llojit të aktivitetit, industrisë, llojit të kolateralit, ditë-vonesat dhe faktorë të tjerë të përshtatshëm.

Flukset e ardhshme monetare nga një grup aktivesh financiare vlerësohen kolektivisht për zhvlerësim duke u bazuar në eksperiencën historike të humbjeve të aktiveve me karakteristika rreziku të ngjashme me ato në grup. Eksperiencat historike e humbjeve, rregullohet në bazë të të dhënave të dukshme për të pasqyruar ndikimet e kushteve që nuk ndikuan vitet në të cilat bazohet eksperiencat historike e humbjeve, për të përjashtuar ndikimet e kushteve në periudhën historike të cilat nuk ekzistojnë aktualisht.

Vlerësimet e ndryshimeve në flukset e ardhshme monetare pasqyrojnë dhe janë konsistente me ndryshimet në të dhënat e dukshme nga viti në vit (ndryshime të tilla si normat e papunësisë, çmimet e pasurive, gjendja e pagesave apo faktor të tjerë tregues të humbjeve në grup, dhe shtrirja e tyre). Metodologjia dhe supozimet e përdorura për vlerësimin e flukseve të ardhshme monetare rishikohen rregullisht për të zvogëluar çdo diferencë ndërmjet vlerësimit të humbjes dhe eksperiencës faktike.

b) Instruente financiare të mbajtura deri në maturim

Banka vlerëson individualisht evidencën objektive të zhvlerësimit në rastin e investimeve të mbajtura deri në maturim. Nëse ka evidencë objektive që ka ndodhur një humbje zhvlerësimi, shumat e humbjes matet si diferencë midis vlerës së mbetur të aktivitetit dhe vlerës aktuale të vlerësimeve të flukseve të ardhshme monetare. Vlera e mbetur e aktivitetit reduktohet dhe shumat e humbjes njihet në fitim ose humbje.

Nëse në vitet e mëpasshme shumat e vlerësuar e humbjes nga zhvlerësimi zvogëlohet si pasojë e një ngjarjeje të ndodhur pas njohjes së zhvlerësimit, çdo shumë e debituar më parë, kreditohet në "Humbje nga zhvlerësimi i aktiveve financiare".

2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme (vazhdim)

2.5 Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

c) Kreditë e ri-negociuara

Kur është e mundur, Banka mundohet të ristrukturojë një kredi në vend që të marrë kolateralin. Kjo mund të përfshijë shtyrjen e marrëveshjeve të ripagesës dhe një marrëveshje të re për kushtet e kredisë. Me ri-negocimin e kushteve, kredia nuk konsiderohet më në vonesë. Drejtimi rishikon vazhdimisht kreditë e ri-negociuara për t'u siguruar që të gjitha kriteret përmbushen dhe pagesat e ardhshme kanë mundësi të kryhen. Kreditë vazhdojnë të jenë subjekt i një vlerësimi individual apo kolektiv për zhvlerësim, të llogaritur duke përdorur normën efektive fillestare të interesit të kredisë.

d) Instrumente financiare të vlefshme për shitje

Ky klasifikim përfshin letrat me vlerë të investimeve të cilat Banka ka ndërmend t'i mbajë për një periudhë të pacaktuar kohe dhe të cilat mund të shiten në përgjigje të nevojave për likuiditet, ose ndryshimet në normat e interesit, normat e këmbimit apo çmimet e kapitalit.

Letrat me vlerë të vlefshme për shitje mbahen me vlerën e drejtë. Të ardhurat nga interesi për letrat me vlerë të vlefshme për shitje llogaritet duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe njihet në fitim ose humbje për vitin. Dividendët mbi instrumentat e kapitalit neto të vlefshme për shitje njihen në fitim ose humbje për vitin kur e drejta e Bankës për të marrë pagesën është njohur dhe është e mundur që dividendët do të mbledhen.

Të gjithë elementët e tjerë të ndryshimeve në vlerën e drejtë njihen në të tjera të ardhura gjithpërfshirëse deri sa investimi çregjistrohet ose zhvlerësohet, kohë në të cilën fitimi ose humbja kumulative është riklasifikuar nga të ardhura të tjera gjithpërfshirëse në fitim ose humbje për vitin.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje për vitin kur ndodhin si rezultat i një apo më shumë ngjarjeve ("ngjarje humbjesh") që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të letrave me vlerë të investimeve të vlefshme për shitje. Një rënie të konsiderueshme ose të zgjatur në vlerën e drejtë të një instrumenti të kapitalit nën koston e tij është një tregues se ajo është e zhvlerësuar. Humbja kumulative nga çvlerësimi - e matur si diferenca midis kostos së blerjes dhe vlerës së drejtë aktuale, minus çdo humbje nga zhvlerësimi mbi atë aset njohur më parë në fitim ose humbje - është riklasifikuar nga të ardhura të tjera të gjithpërfshirëse në fitim ose humbje për vitin.

Humbjet nga zhvlerësimi për instrumenta të kapitalit nuk janë të kthyeshëm dhe të gjitha fitimet pasuese njihen në të ardhura të tjera të gjithpërfshirëse. Në qoftë se, në një periudhë të mëvonshme, vlera e drejtë e një instrumenti të borxhit i klasifikuar si i vlefshëm për shitje, rritet dhe rritja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi humbja nga zhvlerësimi është njohur në fitim ose humbje, humbja nga zhvlerësimi anulohet nëpërmjet fitimit ose humbje për vitin.

2.6 Qiraja

Përcaktimi nëse një marrëveshje është ose përmban një qira, bazohet në thelbin e marrëveshjes e cila kërkon një vlerësim nëse përmbushja e marrëveshjes është në varësi të përdorimit të aktivitetit apo aktiveve specifike dhe marrëveshja transferon një të drejtë për të përdorur aktivin.

2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme (vazhdim)

2.6 Qiraja (vazhdim)

a) Banka si qiramarrës

Qiratë financiare, të cilat i transferojnë bankës në thelb të gjitha risqet dhe përfitimet e lidhura me pronësinë e objektit të qirasë, kapitalizohen me fillimin e afatit të qirasë me vlerën e drejtë të pasurisë së marrë me qira ose, kur është më e vogël, me vlerën e drejtë të pagesave minimale të qirasë dhe përfshihen në "Aktive afatgjata materiale", me detyrimin përkatës ndaj qiradhënësit të përfshirë në "Detyrime të tjera". Pagesat e qirasë ndahen midis shpenzimit financiar dhe detyrimit të qirasë për të arritur një normë konstante interesi mbi gjendjen e mbetur të detyrimit. Shpenzimet financiare regjistrohen drejtpërdrejtë kundrejt të ardhurave në "Shpenzime interesi dhe të ngjashme". Banka nuk kishte marrëveshje të rëndësishme qiraje financiare gjatë periudhës së raportimit.

Aktivet e kapitalizuara të qirasë amortizohen përgjatë kohës më të shkurtër midis jetës së dobishme të vlerësuar të aktivit dhe afatit të qirasë, nëse nuk ka siguri të arsyeshme që banka do të marrë pronësinë e objektit në fund të afatit të qirasë.

Detyrimet e pagesave të qirasë së zakonshme kontabilizohen në mënyrë lineare përgjatë afatit të qirasë dhe përfshihen në "Shpenzime të tjera operative". Kur një qira e zakonshme përfundon para se afati i qirasë të ketë përfunduar, çdo pagesë e kërkuar nga qiradhënësi si penalitet njihet si shpenzim në periudhën kur përfundimi ka ndodhur.

2.7 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat njihen në masën që është e mundur që përfitimet ekonomike do të realizohen nga banka dhe mund të maten në mënyrë të besueshme. Kriteret specifike në vijim duhet të përmbushen që të ardhurat të njihen.

a) Të ardhura dhe shpenzime nga interesi dhe të ngjashme

Të ardhura nga interesi dhe të ngjashme përfshijnë kuponë të fituar nga investimet me të ardhura të pandryshueshme, zbritjen e maturuar dhe primin nga bonot e thesarit dhe të ardhura interesi nga kredi dhe paradhënie.

Për të gjithë instrumentet financiare të matur me kosto të amortizuar dhe instrumentet financiare të klasifikuar si të disponueshëm për shitje që bartin interes, të ardhura ose shpenzime interesi regjistrohet me normën efektive të interesit, e cila është norma që barazon vlerën aktuale të pagesave ose arkëtimeve monetare të ardhshme përgjatë jetës së instrumentit financiar, ose një periudhë më të shkurtër, sipas rastit, me vlerën e mbetur neto të aktivit ose detyrimit financiar.

Përlllogaritja merr parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar (për shembull, mundësitë e parapagimit) dhe përfshin çdo tarifë ose kosto rritëse që lidhet direkt me instrumentin dhe janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit, por përjashton humbjet e ardhshme të kredisë. Vlera e mbetur e aktivit ose detyrimit financiar rregullohet nëse banka rishikon vlerësimet e saj të pagesave dhe arkëtimeve. Vlera e mbetur e rregulluar llogaritet duke u bazuar në normën efektive fillestare të interesit dhe ndryshimi në vlerën e mbetur regjistrohet si të ardhura ose shpenzime interesi. Sapo vlera e regjistruar e aktivit financiar ose e një grupi aktivesh të ngjashme financiare është reduktuar si pasojë e një humbjeje zhvlerësimi, të ardhurat nga interesi vazhdojnë të njihen duke përdorur normën efektive të interesit që përdoret kundrejt vlerës së re të mbetur.

2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme (vazhdim)

2.7 Njohja e të ardhurave (vazhdim)

b) Të ardhura nga tarifat dhe komisionet

Banka fiton tarifa dhe komisione nga një gamë e ndryshme shërbimesh që ajo u ofron klientëve të saj. Të ardhurat nga tarifat mund të ndahen në dy kategori:

Të ardhura nga tarifat ndaj shërbimeve që ofrohen përgjatë një periudhe të caktuar kohe

Tarifat e fituara për kryerjen e shërbimeve përgjatë një periudhe kohe maturohen përgjatë asaj periudhe. Këto tarifa përfshijnë të ardhura nga komisionet dhe menaxhimi i aktiveve, tarifa për mirëbesim dhe për menaxhim dhe këshillime të tjera. Tarifat për angazhimet e kredisë, për kredi që do të përdoren, dhe tarifa për kredi të tjera shtyhen (së bashku me kostot rritëse) dhe njihen si rregullim i normës efektive të interesit kundrejt kredisë.

Të ardhura nga tarifat për shërbime transaksioni

Tarifat që rezultojnë nga negociimi ose pjesëmarrja në negociimin e transaksioneve për një palë të tretë – si marrëveshja e blerjes së aksioneve apo letrave të tjera me vlerë ose blerja apo shitja e bizneseve – njihen në përfundim të transaksionit përkatës. Tarifat ose pjesët përbërëse të tarifave që lidhen me një performancë të caktuar njihen pas përmbushjes së kriterëve përkatës.

c) Të ardhura nga qiraja

Të ardhurat nga qiraja (shënimi 2.6) kontabilizohen në mënyrë lineare përgjatë afatit të qirasë, dhe regjistrohen në fitim ose humbje në "Të ardhura të tjera operative". Banka nuk kishte pasuri investimi të rëndësishme në fund të vitit dhe gjatë periudhës së raportimit.

2.8 Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë gjendjet e parasë dhe depozitat në të parë me një maturitet fillestar tre mujor ose më pak. Për pasqyrën e flukseve monetare, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përbëhen nga arka, llogaritë rrjedhëse me Bankën Qendrore dhe llogaritë në të parë me bankat e tjera dhe me maturitet fillestar tre mujor ose më pak. Rezerva e detyruar me Bankën Qendrore nuk është e disponueshme për veprimtarinë e përditshme të bankës dhe nuk përfshihet si përbërës i mjeteve monetare për pasqyrën e flukseve monetare. Mjetet monetare mbahen me kosto të amortizuar. Më shumë detaje për mjetet monetare gjenden në shënimin 26.

2.9 Aktive afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale mbahen me kosto, duke përjashtuar kostot e shërbimeve të përditshme, minus zhvlerësimin e akumuluar dhe vlerën e rikuperueshme të akumuluar. Amortizimi llogaritet duke përdorur metodën lineare bazuar në koston historike për të zvogëluar koston e aktiveve afatgjata materiale në vlerën e tyre të rikuperueshme përgjatë jetës së tyre të dobishme të vlerësuar. Toka nuk amortizohet.

2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme (vazhdim)

2.9 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

Normat vjetore të zhvlerësimit të aplikuara nga Banka janë si në vijim:

- Ndërtesat: 5%
- Mobilieri dhe pajisje të tjera: 20%
- Automjete: 20%
- Pajisje kompjuterike: 25%
- Përmirësime të ambienteve të marra me qira: më e vogla midis 5% dhe maturimit të kontratës bazë

Vlera e rikuperueshme e aktivitetit dhe jetët e dobishme rishikohen dhe rregullohen, nëse është e nevojshme, në çdo datë raportimi.

Një zë i aktiveve afatgjata materiale regjistrohet kur aktivi shitet ose kur nuk priten më përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi apo shitja e tij. Çdo fitim ose humbje nga regjistrimi i aktivitetit (llogaritur si diferencë midis arketimeve neto nga shitja dhe vlerës së mbetur të aktivitetit) njihet në "Të ardhura të tjera operative" ose "Shpenzime të tjera operative" në fitim ose humbje të vitit, kur aktivi regjistrohet.

2.10 Aktive afatgjata jomateriale

Aktivet afatgjata jomateriale të blera nga banka, mbahen me kosto minus amortizim dhe zhvlerësim të akumuluar, nëse ka, i cili llogaritet në mënyrë lineare duke aplikuar normën e amortizimit prej 15%.

Aktivet afatgjata jomateriale përbëhen tërësisht nga programe kompjuterike të cilat kapitalizohen në bazë të kostove të nevojshme për të blerë aktivin dhe për ta sjellë atë në përdorim. Amortizimi regjistrohet në fitim ose humbje nga momenti kur aktiviteti është disponueshëm për përdorim. Kostot e mirëmbajtjes së programeve njihen si shpenzim kur ato ndodhin. Shpenzimet që përmirësojnë ose shtojnë performancën e programeve kompjuterike më shumë se specifikimet fillestare ose shpenzimet e përditësimeve të programeve, njihen si përmirësime kapitale dhe i shtohen kostos fillestare, nëse mund të maten me besueshmëri.

2.11 Kolaterali i poseduar

Kolaterali i poseduar përfaqëson aktivet financiare dhe jo-financiare të fituara nga Banka në shlyerjen e kredive në vonesë. Asetet njihen fillimisht me vlerën e drejtë kur janë fituar dhe të përfshira në ndërtesat dhe pajisjet, mjetet e tjera financiare, pronat e investimeve ose inventarët brenda aktiveve të tjera në varësi të natyrës së tyre dhe qëllimeve të Grupit në lidhje me marrjen e këtyre aseteve, dhe më pas rimaten dhe llogariten në përputhje me politikën kontabël për këto kategori të aseteve.

2.12 Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Banka vlerëson në çdo datë raportimi ose më shpesh nëse ka ngjarje ose ndryshime rrethanash që tregojnë se vlera e mbetur mund të jetë e zhvlerësuar, nëse ka tregues që një aktiv jofinanciar mund të jetë i zhvlerësuar. Kur ka tregues të tillë, ose kur është i nevojshëm testimi vjetor për zhvlerësim të aktivitetit, banka vlerëson shumën e rikuperueshme të aktivitetit. Kur vlera e mbetur e aktivitetit (ose njësisë gjeneruese të parasë) tejkalon vlerën e rikuperueshme, aktivi (ose njësia gjeneruese e parasë) konsiderohet i zhvlerësuar dhe regjistrohet deri në shumën e rikuperueshme.

2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme (vazhdim)

2.12 Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare (vazhdim)

Për aktivet, në çdo datë raportimi, kryhet një vlerësim për të parë nëse ka tregues që humbjet e zhvlerësimeve të njohura më parë mund të mos ekzistojnë më ose mund të jenë zvogëluar. Nëse ekzistojnë tregues të tillë, vlerësohet shuma e rikuperueshme. Një humbje zhvlerësimi e njohur më parë rimerret, vetëm nëse ka pasur ndryshime në vlerësimet e kryera për të përcaktuar shumën e rikuperueshme të aktivit, që nga njohja e fundit e humbjes së zhvlerësimit. Në këtë rast, vlera e mbetur e aktivit rritet deri në shumën e rikuperueshme.

2.13 Kontratat e garancisë financiare

Kontratat e garancisë financiare kërkojnë që emetuesi të kryejë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për humbje që ai ndesh si pasojë e dështimit të një huamarrësi të caktuar në datën e detyrimit, në përputhje me kushtet e instrumentit të borxhit. Këto garanci financiare u jepen bankave, institucioneve financiare dhe organizmave të tjera për llogari të klientëve për të siguruar kredi, paradhënie dhe produkte të tjera bankare. Garancitë financiare njihen fillimisht me vlerë të drejtë në datën kur garancia jepet. Pas njohjes fillestare, detyrimet e bankës në sajë të këtyre garancive maten me më të madhen midis matjes fillestare minus amortizimin e llogaritur për të njohur në fitim ose humbje tarifat e fituara në mënyrë lineare përgjatë jetës së garancisë dhe vlerësimit më të mirë të shpenzimit të kërkuar për të shlyer çdo detyrim të garancisë financiare në datën e raportimit.

Këto vlerësime përcaktohen në bazë të eksperiencës me transaksione të ngjashme dhe historikut të humbjeve, të mbështetur nga gjykimi i menaxhimit. Çdo rritje në detyrim nga garancitë regjistrohet në fitim ose humbje si shpenzime të tjera operative.

Garancitë dhe angazhimet financiare për të dhënë kredi, njihen fillimisht me vlerën e drejtë, e cila evidencohet normalisht nga shuma e tarifave të marra. Kjo shumë amortizohet në mënyrë lineare përgjatë jetës së angazhimit.

2.14 Pensionet dhe përfitimet e tjera pas punësimit

Banka paguan kontribute në planet pensionale të punonjësve të saj sipas kërkesave të legjislacionit vendas për sigurimet shoqërore. Detyrimet pensionale të bankës, lidhen vetëm me plane me kontribut të përcaktuar. Planet me kontribut të përcaktuar, të bazuar mbi pagat, bëhen me institucionin e administruar nga shteti (Instituti i Sigurimeve Shoqërore) përgjegjës për pagesën e pensioneve. Banka nuk ka detyrime të mëtejshme pas pagesës së kontributit. Kontributet përbëjnë kosto neto periodike për vitin në të cilin ato lindin dhe përfshihen në "Shpenzime personeli" në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

2.15 Provigjionet

Provigjionet njihen kur banka ka një detyrim aktual (ligjor apo konstruktiv) si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe ka shumë mundësi që të ekzistojë një dalje burimesh që kërkohet për të shlyer detyrimin; dhe shuma mund të matet me besueshmëri. Kur ka një numër detyrimesh të ngjashme, mundësia e daljes së burimeve për shlyerje përcaktohet duke marrë në konsideratë kategorinë e detyrimit si të ishte një. Një provigjion njihet edhe nëse mundësia e daljes së burimeve në lidhje me çdo zë të përfshirë në të njëjtën kategori detyrimesh mund të jetë e vogël.

2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme (vazhdim)

2.15 Provigjionet (vazhdim)

Provigjionet maten me vlerën aktuale të shpenzimeve që do të kërkohen për të shlyer detyrimin duke përdorur një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut në lidhje me vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike të lidhura me detyrimin. Rritja në provigjion në sajë të kalimit të kohës njihet si shpenzim interesi.

2.16 Tatimi mbi fitimin

Tatimet mbi fitimin paraqiten në pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, në datën e raportimit. Shpenzimi i tatim-fitimit përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë dhe njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse përveç nëse është njohur në të ardhura të tjera gjithpërfshirëse kur lidhet me transaksione që njihen gjithashtu, në të njëjtën apo në një tjetër periudhë, në të ardhura gjithpërfshirëse.

Tatimi aktual

Aktivët dhe detyrimet aktuale tatimore për vitin në vazhdim dhe vitet e mëparshme maten me shumën që pritët të merret apo t'u paguhet autoriteteve tatimore. Normat tatimore dhe ligjet tatimore që përdoren për përlogaritjen e shumës janë ato që janë në fuqi në datën e raportimit.

Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë llogaritet kundrejt diferencave të përkohshme midis bazave tatimore të aktiveve dhe detyrimeve dhe vlerave kontabël për raportim financiar në datën e raportimit. Detyrimet e shtyra tatimore njihen për të gjitha diferencat e përkohshme, përveç rasteve kur detyrimi i shtyrë tatimor rezulton nga njohja fillestare e emrit të mirë ose e një aktivi apo detyrimi në një transaksion që nuk është kombinim biznesi dhe, në kohën e transaksionit, nuk ndikon as fitim kontabël dhe as fitimin ose humbjen e tatueshme. Aktivët tatimore të shtyra njihen për të gjitha diferencat e përkohshme tatimore, kreditimet tatimore të papërdorura dhe humbjet tatimore të bartura, deri në masën që fitime të ardhshme të mundshme, kundrejt të cilave diferencat e përkohshme të zbritshme dhe kreditimet dhe humbjet tatimore të bartura mund të përdoren, do të jenë të disponueshme, përveç rasteve kur aktivi tatimor i shtyrë që lidhet me diferencat e përkohshme të zbritshme rezulton nga njohja fillestare e një aktivi apo detyrimi në një transaksion që nuk është kombinim biznesi, dhe në kohën e transaksionit, nuk ndikon fitimin kontabël apo fitim ose humbjen e tatueshme.

Vlera e mbetur e aktiveve të shtyra tatimore rishikohet në çdo datë raportimi dhe reduktohet në masën që nuk është më e mundur që të ketë fitim të tatueshëm të mjaftueshëm që të lejojë përdorimin e një pjese ose gjithë aktivin e shtyrë tatimor. Aktivët tatimore të shtyra të panjohura rivlerësohen çdo datë raportimi dhe njihen deri në masën që bëhet e mundur të ketë fitim të tatueshëm në të ardhmen që të lejojë rimarrjen e aktivit të shtyrë tatimor. Aktivët dhe detyrimet e shtyra tatimore maten me normat tatimore që pritët të zbatohen në vitin kur aktivi realizohet ose detyrimi shlyhet, duke u bazuar në normat tatimore (dhe ligjet tatimore) në fuqi në datën e raportimit. Aktivët dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen nëse ekziston një e drejtë e rregulluar me ligj për të netuar aktivin aktual tatimor kundrejt detyrimit aktual tatimor dhe tatimet e shtyra lidhen me të njëjtin autoritet tatimor.

2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme (vazhdim)

2.16 Dividendët nga aksionet e zakonshme

Dividendët nga aksionet e zakonshme njihen si detyrim dhe zbriten nga kapitali kur ato miratohen nga aksionerët e bankës. Dividendët e ndërmjetëm zbriten nga kapitali kur deklarohen dhe nuk varen më nga vendimet e bankës. Dividendët e vitit pas datës së raportimit paraqiten si ngjarje pas datës së raportimit.

2.17 Kapitali aksionar

Aksionet e zakonshme janë të klasifikuara si kapital. Kostot shtesë që lidhen drejtpërdrejtë me lëshimin e aksioneve të reja paraqiten në kapital si një zbritje nga të ardhurat, e netuar nga tatimi. Çdo tejkalim i vlerës së drejtë të shumës së marrë mbi vlerën nominale të aksioneve të lëshuara është regjistruar si premium i aksioneve në kapital.

2.6 Krahasueshmëria

Informacioni krahasues është paraqitur në mënyrë të qëndrueshme duke zbatuar politikat kontabël të Bankës.

3 Menaxhimi i rrezikut financiar

Aktivitetet e Bankës e ekspozojnë atë ndaj rreziqeve financiare dhe këto aktivitete përfshijnë analizën, vlerësimin, pranimin dhe menaxhimin e një shkalle të rrezikut ose kombinim të rreziqeve. Marrja e rrezikut është thelbësor për aktivitetin financiar, dhe rreziqet operationale janë një pasojë e pashmangshme e vazhdimin të aktivitetit. Për këtë arsye qëllimi i Bankës është të arrijë një balancë të përshtatshme ndërmjet rrezikut dhe të ardhurave dhe minimizuar efektet e mundshme negative në performancën financiare të Bankës.

Menaxhimi i rrezikut kryhet nga departamenti i rrezikut në Bankë sipas politikave të miratuara nga Bordi i Drejtorëve që mbulojnë: rrezikun e kredisë, rrezikun e likuiditetit, rrezikun e tregut dhe rreziqe të tjera operationale. Rreziku i tregut përfshin rrezikun e monedhës, normën e interesit dhe rreziqe të tjera të çmimeve.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Bankës janë të krijuar për të identifikuar dhe analizuar këto rreziqe, për të vendosur kufizime dhe kontrole të duhura, dhe për të monitoruar rreziqet dhe respektimin e limiteve me anë të sistemeve të informacionit të besueshme dhe të përditësuara. Banka rishikon rregullisht politikat dhe sistemet e saj të menaxhimit të rrezikut për të pasqyruar ndryshimet në tregje, produkte dhe praktikë më të mira në zhvillim, duke qenë në përputhje me politikat e grupit dhe rregulloret e Bankës së Shqipërisë.

Llojet më të rëndësishme të rrezikut janë rreziku i kredisë, rreziku i likuiditetit, rreziku i tregut dhe rreziqe të tjera operationale. Rreziku i tregut përfshin rrezikun e monedhës, normën e interesit.

3 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

3.1 Rreziku i kredisë

Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë, i cili është rreziku që një palë tjetër të shkaktojë humbje financiare ndaj bankës duke dështuar të përmbushë detyrimet ndaj Bankës. Rreziku i kredisë është më i rëndësishëm për aktivitetin e bankës; për këtë arsye Drejtimi menaxhon me kujdes ekspozimin e Bankës ndaj rrezikut të kredisë. Ekspozimet e kredisë rezultojnë kryesisht nga aktivitetet kredidhënëse që sjellin kreditë dhe paradhëniet, dhe aktivitetet e investimit që sjellin letra me vlerë të borxhit dhe letra të tjera me vlerë në portofolin e aktiveve të bankës. Edhe në instrumentet financiare jashtë bilancit ekziston rreziku i kredisë. Menaxhimi dhe kontrolli i rrezikut të kredisë janë centralizuar në skuadrën e menaxhimit të rrezikur në departamentin e rrezikur si në nivel lokal ashtu edhe në nivel grupi (Veneto Banca S.c.p.a.), i cili i raporton Bordit të Drejtorëve.

Departamenti i menaxhimit të rrezikut të kredisë ka detyrat e mëposhtme:

- Të kryejë aktivitete të matjes dhe kontrollin e rrezikut të kredisë dhe të kunderpartisë për të cilën Banka është e ekspozuar në përputhje me rregulloret lokale dhe treguesve të Shoqërisë mëmë, duke përdorur, nëse është e nevojshme, bashkëpunimin e funksioneve përkatëse;
- Të kryejë analiza të portofolit për lloje të rrezikut, segmente të konsumatorëve, sektorët e veprimtarisë ekonomike;
- Të kontribuojë në zbatimin e sistemit të brendshëm të klasifikimit dhe kujdeset në përditësimin e këtij klasifikimi për klientët duke kontrolluar qëndrueshmërinë dhe korrektesinë e tyre;
- Të vlerësojë rrezikun e çdo aplikuesi për kredi, duke realizuar një vetë vlerësim të pavarur për çdo praktikë dhe duke gjykuar mbi veprimtarinë e aplikuesit;
- Të përgatisë analiza statistikore bazuar në të dhëna historike për rrezikun e kredisë, për qëllime të provigjionit;
- Të zhvillojë metodologji të përshtatshme për llogaritjen e parametrave të rrezikut të kredisë;
- Të rishikojë përputhshmërinë e njësive të biznesit me limitet e ekspozimit të miratuara, duke përfshirë ato për industrinë e zgjedhura, rrezikut të vendit dhe llojeve të produktit. Raporte mbi cilësinë e kredisë së portofolit lokal i jepen rregullisht departamentit të kredisë për të cilat ndërrmeren masat e duhura korrigjuese.
- Të ofrojë këshilla, udhëzime dhe aftësi specialiste specifike ndaj njësive të biznesit për të promovuar praktikën më të mira në Bankë për administrimin e rrezikut të kredisë.
- Njësia e Menaxhimit të Rrezikut zhvillon sistemet e menaxhimit të rrezikut të kredisë dhe infrastrukturën e nevojshme duke analizuar rezultatet dhe raportimin tek Drejtimi.
- Të përgatisë Bankës për implementimin e mëtejshëm të Basel II.
- Menaxhimi i marrëdhënieve me Bankën e Shqipërisë (Banka Qendrore), me Banken mëmë dhe/ose autoritetet e tjera në drejtim të efektivitetit të Menaxhimit të rrezikut të kredisë.

Komiteti i Auditimit dhe Departamenti i Auditimit të Brendshëm ndjekin përputhshmërinë me politikat dhe procedurat.

Procedurat e mëposhtme përshkruajnë matjen e rrezikut të kredisë për qëllime të menaxhimit të portofolit. Banka përdor një sistem të brendshëm të klasifikimit të bazuar në politikat e grupit. Banka përdor vlerësim të brendshëm dhe metodën e provigjionimit si më poshtë:

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

3 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**3.1 Rreziku i kredisë (vazhdim)****3.1.1 Matja e rrezikut kreditor**

Renditja e aktiveve financiare	Nendarje	Kriteri	Ekspozimi	Metoda e provigjonomit
I Standard	A) Standard B) Standard me mundësi përkeqësimi	1) Pagesë me vonesë <90 ditë 2) Pagesë me vonesë >90 ditë dhe shuma e papaguar <5% e ekspozimit		Kolektive
II Të vonuara	A) Te vonuara	1) Pagesë me vonesë >90 ditë dhe ≤270 ditë dhe shuma e papaguar >5% e ekspozimit 2) Pagesë me vonesë >270 ditë dhe shuma e papaguar <10% e ekspozimit	≤ 300,000 Euro ≤ 300,000 Euro	Kolektive Kolektive
	B) Të skaduara ose të përkeqësuar, me vlerë të konsiderueshme	Pagesë me vonesë >270 ditë dhe shuma e papaguar >10% e ekspozimit	> 300,000 Euro	Individuale
III Të dyshimta	A) Të dyshimta në proces ristrukturimi	Ekspozimet të cilat janë në proces të zbatimit të masave që lidhen me marrëveshjet dypalëshe për ristrukturimin e borxhit.	≤ 150,000 Euro	Kolektive
	B) Të ristrukturuara	Ekspozimet, përveç atyre të klasës "Te vonuara" të cilat finalizohen me marrëveshje ristrukturimi.	≤ 150,000 Euro	Kolektive
	C) Të dyshimta	Ekspozimet të cilat janë vlerësuar si në pamundësi për të shlyer borxhin në përputhje me kontratën.	> 150,000 Euro	Individuale
VI Të humbura		Klientët me paaftësi pagese dhe ata për të cilët banka ka filluar procedurën ligjore për ekspozimet brenda dhe jashtë bilancit (me ose pa vendim gjykatë), ose në situata të ngjashme pavarësisht nga fondi i provigjoniit krijuar nga banka. Ky kategorizim vlerësohet analitiksht përmes procesit të analizës financiare dhe miratimit nga autoriteti kompetent.		Individuale

I – Standard:

Aktivet financiare klasifikohen në grupin I nëse plotësojnë kriteret e mëposhtme:

A)

- Historik i rregullt pagesash me ecure normale, të cilat nuk tregojnë shenja të veçanta anomalie që do ta klasifikonin klientin ndryshe nga normalja.
- Pozicione të shëndetshme financiare ku nuk ka arsye të supozohen përkeqësime të qëndrueshme të këtij pozicioni.

B)

- Vonesat ose tejkalimet e limiteve nuk duhet të jenë të një natyre të vazhdueshme
- Pjesa e tejkalimit (shuma) duhet të jetë më e vogël se 5% e ekspozimit.

II- Të vonuara:

Aktivet financiare klasifikohen në grupin II nëse plotësojnë kriteret e mëposhtme:

A)

- Ekspozimet – përveç atyre të klasifikuara si të dyshimta – të cilat pasqyrojnë mos-përmbushje (pagesa të vonuara, kredi të klasifikuara si të vonuara, vazhdimisht kalojnë limitet).
- Vonesa mbi 90 ditë, duke përjashtuar tejkalimet e limiteve të kredisë për të cilat një kthim gradual brenda limiteve normale operative mund të parashikohet në mënyrë të arsyeshme.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

3 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

3.1 Rreziku i kredisë (vazhdim)

3.1.1 Matja e rrezikut kreditor

B)

- Ekspozimet ndaj klientëve të cilët tregojnë shenja objektive të një situatë të vështirë financiare, e cila pritët të tejkalohet brenda një kohe të arsyeshme.
- Kjo është e aplikueshme pavarësisht garancive (personale apo të vërteta) të cilat mbështesin këto ekspozime. Kjo nuk përfshin kredi të cilat kanë parregullsi të shkaktuara nga faktorët e rrezikut të vendit.
- Për këtë arsye, prania e vonesave për më shumë se 270 ditë për një shumë më të madhe se 10% e ekspozimit.

III - Të dyshimta:

Aktivët financiarë klasifikohen në grupin III nëse plotësojnë kriteret e mëposhtme:

A)

- Klasifikimi në këtë kategori vendoset nga organi vendimmarrës rreth pamundësisë që debitori të përmbushë në mënyrë të plotë detyrimet e tij të kredisë (principalit dhe/ose interes), pa iu drejtuar veprimeve si ekzekutimi i kolateralit. Ky vlerësim duhet të kryhet pavarësisht nga prania e ndonjë shume të maturuar dhe të papaguar. Kontratat e rinegociuara të cilat nuk shkaktajnë ndonjë humbje për bankën.
- Nuk është e nevojshme të priten simptoma të qarta anomalie (këstit të papaguar, interesit etj) dhe ku ka elemente që përfshijnë rrezikun e përkeqësimit të huamarresit (për shembull: një krizë e sektorit industrial në të cilën ai operon).

B)

- Statusi i kredive të ristrukturuara përcaktohet në mënyrë analitike, në bazë të vlerësimit të aftësisë paguese dhe miratimit të klasifikimit nga organi vendimmarrës.
- Për shkak të përkeqësimit të kushteve ekonomike dhe financiare të huamarresit, një bankë (ose një grup bankash) bie dakord për ndryshimet në kushtet fillestare të kontratës (për shembull, shtyrjen e afateve, reduktimin e borxhit dhe / ose të interesit), që shkakton një humbje për Bankën. Ekspozimet ndaj shoqërive për të cilat pritët ndalimi i veprimtarisë së biznesit (për shembull, rastet e falimentimit vullnetar apo situata të ngjashme) janë të përjashtuara. Këto raste nuk përfshijnë elemente ku parregullsitë vijnë për shkak të faktorëve të rrezikut të vendit.

C)

- Në rastet e trendeve seriozisht anomale në llogari (shuma të mëdha të papaguara, çeqe të shumta të pezulluara për shkak të zbulimit, "overdrafts" me tejkalime limiti të përsëritura që nuk hyjnë brenda afateve, paradhënie importi që nuk mbulohen në maturim, paradhënie për faturat vendase ose të huaja për të cilat pagesat e pritura në maturim nuk janë kryer, etj).
- Në rastet e parregullësive serioze të vërejtura në raportet për Regjistrin Qëndror të Kredive (tejkalime të vazhdueshme dhe të rëndësishme, kreditë me këste të papaguara, detyrime jo proporcionale në krahasim me qarkullimin);
- Në rastet shqetësuese të paraqitur në pasqyrat financiare (kapitalit aksioner të pamjaftueshme apo negative, humbje për vitin, borxhe serioze, dështimi për të paraqitur pasqyrat financiare për subjektet e detyruara për ta bërë këtë, etj);
- Në rast të ndodhjes se ngjarjeve negative të cilat mund të rrezikojnë pozitën e kredisë;
- Në rast të vdekjes së huamarresit ose të një ortaku / aksionari (në të dy tipologjitë e shoqërive të thjeshta dhe shoqërive aksionare), duke vlerësuar të sipas rastit pasojat e kësaj ngjarjeje;
- Në ratite e kërkesave për përtëritje apo zgjatje të periudhës së faljes ose të një moratoriumi të mëparshëm;
- Në rastet e kërkesave për shtyrje të pagesës së interesit në llogaritë rrjedhëse.

3 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

3.1 Rreziku i kredisë (vazhdim)

3.1.1 Matja e rrezikut kreditor

IV- Të humbura:

Aktivitetet financiare klasifikohen në grupin E nëse plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Ekspozimi ndaj subjekteve të cilat janë në situatën falimentimit (edhe pse jo e certifikuar ligjërisht) ose kryesisht në situata të ngjashme, pa marrë parasysh parashikimet e humbjes së kryera nga Banka. Si pasojë kjo nuk varet nga garancitë e mundshme (me apo pa kolateral) të cilat mbulojnë ekspozimin.
- Kjo kategori përfshin pozicionet ndaj të cilave janë marrë masa ligjore për kthim dhe pozicionet e dyshimta për të cilat afatet maksimale kanë skaduar dhe operacionet normale nuk kanë rifilluar.

Banka përdor një model provigjioni kolektiv për klasifikimet standarde, të vonuara dhe të dyshimta, dhe një politikë individuale zhvlerësimi siç përshkruhet në tabelën në paragrafin 3.1.1. Logjika bazë e modelit kolektiv është e bazuar në metodologjinë e provigjionimit të grupit sipas vlerësimit të probabilitetit të humbjes për një periudhë 5 vjeçare.

3.1.2 Politikat për kontrollin dhe zbutjen e Rrezikut

Departamenti i Rrezikut krijon strategjitë për të garantuar që Banka vepron në përputhje të plotë me Rregulloret e brendshme dhe politikat e grupit, si dhe në funksion të strategjisë së zhvillimit të Bankës. Një sërë procesesh dhe procedurash janë krijuar në mënyrë që të monitorohet përqëndrimi i portofolit në aspektin individual/grup ekonomik të palëve të treta, sektorëve dhe industrive, segmente të konsumatorëve, zonave gjeografike etj.

Përveç sinjalizimeve të zhvilluara për një monitorim efikas dhe reagim të shpejtë në rast të ndonjë shkeljeje të limiteve, banka zbut rrezikun e kredisë edhe nëpërmjet kolateralit:

(a) Kolaterali

Banka operon brenda kufijve të përcaktuar sipas procedurave të miratuara për pranimin e kolateralit, si teknike kryesore në zbutjen e rrezikut të kredisë. Llojet kryesore të kolateralit të pranuar nga Banka janë:

- Pasuria e patundshme (toka e destinuar për qëllime tregtare, pronat tregtare dhe rezidenciale). Në lidhje me vlerën e tregut, për qëllime të parashikimit të humbjeve, aplikohen kriteret e mëposhtme
- Makineri dhe Pajisje, në lidhje me vlerën e tregut, për qëllime të parashikimit të humbjeve, aplikohen kriteret e mëposhtme:
- Të drejta monetare që rrjedhin nga një kontratë;

Kolateralet janë vlerësuar nga vlerësuesit e jashtëm. Në varësi të klasës / llojit të kolateralit ka norma specifike zbritjeje të aplikuara, duke filluar nga 0% në 63%. Kjo është për shkak të kërkesave komplekse ligjore dhe vonesave të konsiderueshme në kthimin dhe realizimin e kolateralit.

Në funksion të llojit të produktit dhe segmentit të klientelës, janë krijuar grupe të kredive për të cilat janë pranuar kolaterale të natyrave të ndryshme siç përshkruhet më sipër.

Kreditë për korporatat janë të siguruara zakonisht me kolaterale tip pasuri të patundshme, ndërsa kreditë individuale janë ose të pasiguruara (kredi personale) ose të siguruara nga prona rezidenciale (kreditë hipotekare).

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

3. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**3.1 Rreziku i kredisë (vazhdim)****3.1.3 Politikat e zhvlerësimit dhe provigjionimit**

Provigjioni për zhvlerësim i paraqitur në bilanc në fund të vitit rrjedh nga secila prej kategorive të brendshme të renditjes. Tabela në vijim tregon përqindjen e zërave në bilancin e bankës në lidhje me kreditë dhe paradhëniet dhe provigjionin përkatës për secilën kategori:

Renditja e bankës	31 dhjetor 2015		31 dhjetor 2014	
	Kredi dhe paradhënie (%)	Niveli i provigjionit (%)	Kredi dhe paradhënie (%)	Niveli i provigjionit (%)
Standard	65.20	7.33	85.40	10.72
Të vonuar	12.46	14.65	2.22	3.18
Të dyshimtë	9.44	9.25	7.51	40.60
Të humbur	12.90	68.77	4.87	45.50
Totali	100.00	100.00	100.00	100.00

3.1.4. Ekspozimi maksimal ndaj Rrezikut të kredisë përpara kolateralit dhe garancitë e tjera

Ekspozimi maksimal	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Ekspozimet e rrezikut kreditor lidhur me aktivet në bilanc është si në vijim:		
Mjete monetare dhe gjendje me Bankën Qendrore	5,475,696	4,203,967
Kredi dhe paradhënie për bankat	1,979,069	1,883,999
Kredi dhe paradhënie për klientët:		
Kreditë për individë:		
– Konsumatore/paradhënie	1,840,811	2,137,885
– Karta krediti	36,747	31,248
– Hipotekore	260,847	239,341
	2,138,405	2,408,474
Kredi për korporatat:		
– Klientë të mëdhenj	5,677,749	4,539,970
– Ndërmarrje të vogla dhe të mesme (SME)	9,926,978	11,384,640
	15,604,727	15,924,610
Komisione të kredive të shtyra	(76,382)	(88,150)
Minus: Zbritje për zhvlerësimin e humbjeve	(1,728,598)	(975,530)
Totali i kredive dhe paradhënieve për klientët	15,938,152	17,269,404
Instrumente financiare të mbajtura deri në maturim	-	9,987
Instrumente financiare të mbajtura për shitje	568,936	2,132,071
Ekspozimet e rrezikut kreditor lidhur me aktivet jashtë bilanci është si në vijim:		
Letër garancie	1,760,494	1,812,738
Letër kreditë	-	559,154
Angazhime kredie	514,924	1,545,055
Më 31 dhjetor	26,237,272	29,416,374

Tabela më sipër paraqet ekspozimin e rrezikut të kredisë për Bankën më 31 dhjetor 2015 dhe 2014, pa marrë parasysh kolateralët e regjistruar apo garancitë e tjera të kredisë. Për aktivet në bilanc, ekspozimet e mësipërme bazohen në vlerën e mbetur të raportuar në bilanc. Siç tregohet më sipër, 60.75% e ekspozimit total përbëhet nga kreditë dhe paradhëniet për klientët (2014: 58.71%); 2.17% përbëhet nga investime në instrumente borxhi (2014: 7.28%); 20.87% përbëhet nga mjete monetare dhe gjendje me Bankën Qendrore (2014: 14.29%) dhe 7.54% përbëhet nga kredi dhe paradhënie për bankat (2014: 6.40%).

Veneto Banka Sh.A.**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare**

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

3 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**3.1 Rreziku kreditor (vazhdim)****3.1.5 Kredi dhe paradhënie**

Kreditë dhe paradhëniet dhe aktivet e tjera financiare përmbledhen si në vijim:

Kredite dhe paradhëniet	2015		2014	
	Kredi dhe paradhënie për klientët	Rezerva e detyrueshme	Kredi dhe paradhënie për klientët	Rezerva e detyrueshme
As të vonuara dhe as të zhvlerësuar	7,002,834	1,979,069	9,387,702	1,883,999
Me vonesë por jo të zhvlerësuar	4,962,825	-	6,974,734	-
Të zhvlerësuar individualisht	5,777,473	-	1,970,648	-
Bruto	17,743,132	1,979,069	18,333,084	1,883,999
Minus: provigjion për zhvlerësim	(1,728,598)	-	(975,530)	-
Neto	16,014,534	1,979,069	17,357,554	1,883,999
Komisionet e kredive të shtyra	(76,382)	-	(88,150)	-
Totali	15,938,152	1,979,069	17,269,404	1,883,999

Informacion i mëtejshëm për provigjionet e zhvlerësimit për kreditë dhe paradhëniet për bankat dhe klientët paraqitet në shënimet 14 dhe 15.

Cilësia e kredisë së portofolit të kredive dhe paradhënieve e detajuar sipas segmenteve të sistemit të brendshëm të renditjes së aplikuar nga Banka, paraqitet si më poshtë:

Kredite dhe paradhëniet për klientet						
31 dhjetor 2015	Individuale		Korporate			Totali i kredive dhe paradhënieve për klientet
	Konsumatore /paradhenie	Karta krediti	Hipotekare	Klientë të mëdhenj	SME	
Klasifikimi:						
Standard	1,383,002	32,440	215,315	3,717,255	6,171,888	11,519,900
Të vonuara	89,760	1,297	13,483	145,875	1,950,670	2,201,085
Të dyshimta	231,285	1,273	15,151	708,866	710,748	1,667,323
Të humbur	122,307	1,736	14,829	1,081,921	1,057,649	2,278,442
Provigjioni	(113,203)	(2,121)	(8,136)	(612,453)	(992,685)	(1,728,598)
Totali	1,713,151	34,625	250,642	5,041,464	8,898,270	15,938,152

Kredite dhe paradhëniet për klientet						
31 dhjetor 2014	Individuale		Korporate			Totali i kredive dhe paradhënieve për klientet
	Konsumatore /paradhenie	Karta krediti	Hipotekare	Klientë të mëdhenj	SME	
Klasifikimi:						
Standard	1,955,792	30,005	218,508	3,964,783	9,412,429	15,581,517
Të vonuara	44,895	868	6,591	42,359	309,698	404,411
Të dyshimta	42,643	-	-	233,877	1,093,740	1,370,260
Të humbur	84,277	224	13,090	277,123	514,032	888,746
Provigjioni	(59,736)	(261)	(3,828)	(193,256)	(718,449)	(975,530)
Totali	2,067,871	30,836	234,361	4,324,886	10,611,450	17,269,404

Veneto Banka Sh.A.**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare***(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)***3 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****3.1 Rreziku kreditor (vazhdim)****3.1.5 Kredi dhe paradhënie (vazhdim)**

Klasifikimi i kredive dhe paradhënieve ndaj klientëve si "As të vonuara as të zhvlerësuar", "Të vonuara por jo të zhvlerësuar" dhe "Të zhvlerësuar individualisht" për periudhën 31 dhjetor 2015 tregohet në tabelën e mëposhtme:

31 dhjetor 2015	Kredite dhe paradheniet per klientet					Totali
	Individuale		Korporata			
	Konsumator /Paradhenie	Hipotekare	Karta krediti	Kredi ndaj korporatave	SME	
As te vonuara as te zhvlerësuar						
Standard	1,043,582	139,566	24,684	2,499,490	3,248,572	6,955,894
Të vonuara	1,588	-	-	8,242	-	9,830
Të dyshimtë	69	-	338	-	-	407
Totali as te vonuara as te zhvleresuar	1,045,239	139,566	25,022	2,507,732	3,248,572	6,966,131
Të vonuara por jo të zhvlerësuar						
- deri në 30 ditë vonesë	250,473	41,974	6,240	792,827	2,559,010	3,650,524
- 30 deri në 90 ditë vonesë	90,450	33,776	886	64,810	309,451	499,373
- 91 deri në 180 ditë vonesë	44,167	15,152	1,574	27	98,789	159,709
- 181 deri në 360 ditë vonesë	94,576	2,561	592	360,186	55,688	513,603
- mbi 360 ditë vonesë	30,487	10,922	243	32,782	30,338	104,772
Totali të vonuara por jo të zhvlerësuar	510,153	104,385	9,535	1,250,632	3,053,275	4,927,980
Kredi te zhvleresuar individualisht (bruto)						
- deri në 30 ditë vonesë	127,149	-	-	424,062	674,945	1,226,156
- 30 deri në 90 ditë vonesë	-	-	-	224,358	15,635	239,993
- 91 deri në 180 ditë vonesë	8,541	-	-	-	1,009,713	1,018,254
- 181 deri në 360 ditë vonesë	33,168	-	1,970	499,335	890,722	1,425,195
- mbi 360 ditë vonesë	102,103	14,829	220	747,797	998,092	1,863,041
Total kredi të zhvlerësuar individualisht (bruto)	270,961	14,829	2,190	1,895,552	3,589,107	5,772,639
Minus provigjioni per zhvlerësim	(113,203)	(8,137)	(2,121)	(612,453)	(992,684)	(1,728,598)
Totali kredi dhe paradhënie ndaj klientëve	1,713,150	250,643	34,626	5,041,463	8,898,270	15,938,152

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

3 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**3.1 Rreziku kreditor (vazhdim)****3.1.4 Kredi dhe paradhënie (vazhdim)**

Klasifikimi i kredive dhe paradhënieve ndaj klientëve si "As të vonuara as të zhvlerësuar", "Të vonuara por jo të zhvlerësuar" dhe "Të zhvlerësuar individualisht" për periudhën 31 dhjetor 2014 tregohet në tabelën e mëposhtme:

31 dhjetor 2014	Kredite dhe paradheniet per klientet					Totali
	Individuale			Korporata		
	Konsumator/P aradhenie	Hipotekare	Karta krediti	Kredi ndaj korporatave	SME	
As te vonuara as te zhvlerësuar						
Standard	1,205,936	81,697	21,526	1,760,135	5,748,901	8,818,195
Të vonuara	108	-	-	-		108
Të dyshimtë	1535	-	168	-	2851	4554
Totali as te vonuara as te zhvleresuara	1,207,579	81,697	21,694	1,760,135	5,751,752	8,822,857
Të vonuara por jo të zhvlerësuar						
- deri në 30 ditë vonesë	436,520	40,100	6,301	1,387,221	1,904,594	3,774,736
- 30 deri në 90 ditë vonesë	134,793	75,378	1728	59,656	1,256,401	1,527,956
- 91 deri në 180 ditë vonesë	195,609	21,333	691	171855	369,061	758,549
- 181 deri në 360 ditë vonesë	27,027	6,591	-	177,104	236,234	446,956
- mbi 360 ditë vonesë	1,716	-	-	408,858	22,509	433,083
Totali të vonuara por jo të zhvlerësuar	795,665	143,402	8,720	2,204,694	3,788,799	6,941,280
Kredi te zhvleresuara individualisht (bruto)						
- deri në 30 ditë vonesë	-	-	-	45,962	473,621	519,583
- 30 deri në 90 ditë vonesë	-	-	-	10,256	69,077	79,333
- 91 deri në 180 ditë vonesë	-	-	-	3	4	7
- 181 deri në 360 ditë vonesë	43	-	459	-	224,774	225,276
- mbi 360 ditë vonesë	124,319	13,090	225	497,091	1,021,873	1,656,598
Total kredi të zhvlerësuar individualisht (bruto)	124,362	13,090	684	553,312	1,789,349	2,480,797
Minus provigjioni per zhvlerësim	(59,736)	(3,828)	(262)	(193,256)	(718,448)	(975,530)
Totali kredi dhe paradhënie ndaj klientëve	2,067,870	234,361	30,836	4,324,885	10,611,452	17,269,404

(i) Kredi dhe paradhënie për bankat

Nuk ka kredi dhe paradhënie për bankat më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014, të cilat janë me vonesë por jo të zhvlerësuar.

*a) Kredi dhe paradhënie të zhvlerësuar individualisht**(i) Kredi dhe paradhënie për klientët*

Detajimi i shumës bruto të kredive dhe paradhënieve sipas kategorisë së bashku me vlerën e drejtë të kolateraleve përkatëse të regjistruara si siguri për bankën janë si në vijim:

Veneto Banka Sh.A.**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare***(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)***3 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****3.1 Rreziku kreditor (vazhdim)****3.1.5 Kredi dhe paradhënie (vazhdim)**

31 dhjetor 2015	Konsumatore dhe karta Visa	Korporatat		Totali
31 dhjetor 2015				
Kredi të zhvlerësuar individualisht	287,979	3,589,107	1,895,552	5,772,638
Vlera e drejtë e kolateralit	215,808	6,276,778	2,009,471	8,502,057
31 dhjetor 2014				
Kredi të zhvlerësuar individualisht	138,136	1,789,348	553,312	2,480,796
Vlera e drejtë e kolateralit	205,887	382,187	961,183	1,549,257

Gjatë 2015, në përputhje me kërkesat e Bankës së Shqipërisë, Banka ka rikategorizuar kreditë ndaj shoqërive të vogla dhe të mesme ("SME") dhe korporata të mëdha. Banka përdor vlerësues të licencuar për vlerësimin e pasurive të marra si kolateral. Sistemi bankar ka patur gjithmonë vështirësi në ekzekutimin e kolateraleve për arsye që lidhen me anën ligjore e procedurale të tij. Gjatë vitit 2015 situata e përgjithshme mbi ekzekutimin e kolateraleve vazhdon të ndiejë përmirësimin nga shpërndarja e licencave për zyra private përmbarimore, të cilat kanë reduktuar afatet e ekzekutimit.

Me gjithë vështirësitë në ekzekutimin e rimarrjes së kolateralit, menaxhimi i bankës do të ndjekë me vendosmëri borxhet e papaguara me të gjitha mjetet ligjore në dispozicion.

Informacioni për kolateralet më 31 dhjetor 2015 si vijon:

31 dhjetor 2015	Konsumatore dhe karta Visa	SME	Korporatat e mëdha	Totali
<i>Në mijë Lekë</i>				
Kredi të garantuara nga banka të tjera	-	88,662	-	88,662
Kredi të garantuara nga partitë e tjera, duke përfshirë sigurimin e kredive	86,808	831,024	38,618	956,450
<i>Kredi të kolateralizuara me:</i>				
- pasuri të patundshme rezidenciale	631,238	961,606	310,627	1,903,471
- pasuri të patundshme komerciale	663,589	3,742,423	3,284,492	7,690,504
- pengje mbi pagën	28,487	-	-	28,487
- të drejta monetare kontraktuale	32,104	650,862	108,494	791,460
- depozita në kesh	247,775	111,216	98,811	457,802
- tokë, makineri dhe paisje	232,536	2,594,993	1,188,497	4,016,027
Kredi të pakolateralizuara	199,342	910,169	624,376	1,733,888
Totali Kredi dhe paradhënie për klientët	2,121,879	9,890,955	5,653,916	17,666,750

Veneto Banka Sh.A.**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare***(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)***3 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****3.1 Rreziku kreditor (vazhdim)****3.1.5 Kredi dhe paradhënie (vazhdim)**

Informacioni për kolateralet më 31 dhjetor 2014 si vijon:

31 dhjetor 2014 <i>Në mijë Lekë</i>	Konsumatore dhe karta Visa	SME	Korporatat e mëdha	Totali
Kredi të garantuara nga banka të tjera	-	-	3,308	3,308
Kredi të garantuara nga partitë e tjera, duke përfshirë sigurimin e kredive	123,703	1,107,971	356,209	1,587,883
<i>Kredi të kolateralizuara me:</i>				
- pasuri të patundshme rezidenciale	474,778	696,143	120,595	1,291,516
- pasuri të patundshme komerciale	674,067	3,467,836	1,536,078	5,677,982
- pengje mbi pagën	19,131	-	-	19,131
- të drejta monetare kontraktuale	231,880	233,745	452,085	917,711
- depozita në kesh	395,539	254,705	243,062	893,306
- tokë, makineri dhe paisje	286,561	2,957,669	895,073	4,139,303
Kredi të pakolateralizuara	191,233	2,611,831	911,731	3,714,795
Totali Kredi dhe paradhënie për klientët	2,396,893	11,329,900	4,518,141	18,244,934

Vlera e drejtë e kolateraleve pa marrë në konsideratë normat e skontimit më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 është si vijon:

Vlera e drejtë e kolateralit		
<i>Lloji i kolateralit</i>	2015	2014
Pronë	20,386,591	21,077,231
Komerciale	17,121,015	18,537,031
Rezidenciale	3,265,576	2,540,199
Pengje	3,523,110	2,747,742
Para	374,417	2,179,461
Kolaterale të tjera të garantuara nga palët e treta	5,167,687	8,673,936
Totali	29,451,806	34,678,370

(ii) Efekti financiar i kolateralit mbi provigjionin

Efekti financiar i kolateralit prezantohet si ndikim i tij në përmirësimin e fondit të provigjionit dhe zhvlerësimit të njohur në fund të periudhës raportuese. Pa mbajtjen e kolateralit dhe garancive të tjera të kredisë, fondet e provigjionimit / zhvlerësimit do të ishin më të larta me shumat e mëposhtme:

	2015	2014
Kredi korporatash	387,508	133,947
Kredi individuale (konsumatore, karte krediti, hipotekore)	41,182	28,462
SME	266,050	215,045

(iii) Kredi dhe paradhënie per bankat

Nuk ka kredi dhe paradhënie për bankat që janë individualisht të zhvlerësuar më 31 dhjetor 2015 dhe 2014.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

3 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

3.1 Rreziku kreditor (vazhdim)

3.1.6 Kreditë dhe paradhëniet e ri-negociuara

Një prej metodologjive Banka përdor për të përmirësuar cilësinë e portofolit është ristrukturimi i konsumatorëve në vështirësi. Ristrukturimi, ndodh kur konsumatori është në vështirësi të përkohshme financiare, dhe shpesh i referohet një zgjatje e pagesave (duke e vendosur pagesat e humbura në fund të mbajtësit), rishkrujtje (duke ndryshuar termin kontratë) ose shtyrje (duke shtyrë afatin e pagesës pa ndryshuar mbajtësin) por vetëm nëse këto ndryshime sjellin një humbje. Gjatë vitit 2015 rinegociimet kanë arritur vlerën 1,1 mld Lekë (1,4 mld Lekë).

3.1.7 Mjete monetare dhe gjendje me Bankën Qëndrore

Më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 shumat me Bankën Qëndrore dhe me bankat korrespondente nuk ishin në vonesë dhe nuk ishin të zhvlerësuar.

3.1.8 Instrumentet e borxhit, bonot e thesarit dhe instrumente te tjerë

Instrumentet e mbajtura deri në maturim dhe ato të mbajtura për shitje përbëhen nga bono thesari me maturim deri në 1 vit dhe obligacione me 2 deri në 3 vite maturimi. Emetuesi i këtyre instrumenteve është Qeveria Shqiptare. Shërbimi i vlerësimit të Standard & Poor's ka vendosur renditjen 'B' për monedhë të huaj dhe monedhë vendase për këto instrumente të Shqipërisë. Më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 këto investime nuk ishin në vonesë dhe nuk ishin të zhvlerësuar.

3.1.9 Përqendrimi i rrezikut të aktiveve financiare me rrezik ndaj ekspozimit të kredisë

(a) Sektorët gjeografik

Kredite dhe paradheniet për bankat janë vendosur me banka të vendeve anëtare të OECD. Të gjitha aktivet e tjera financiare janë vendosur në Shqipëri.

(b) Sektorët e industrisë

Analiza e ekspozimit kryesor të bankës në kredi dhe paradhënie për klientët sipas industrisë paraqitet në shënimin 15.

3.2 Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, si normat e interesit, çmimet e kapitalit, kurset e këmbimit dhe normat e kredisë (që nuk lidhen me ndryshimet në gjendjen kreditore të detyruesit/emetuesit) do të ndikojnë të ardhurat e bankës ose vlerën e pjesëmarrjeve të saj në instrumentet financiare. Objektivi i menaxhimit të rrezikut të tregut është menaxhimi dhe kontrolli i ekspozimeve të rrezikut brenda parametrave të pranueshëm, duke maksimizuar kthimin e rrezikut. Çështjet e rrezikut të tregut ndiqen vazhdimisht dhe rregullisht nga "Komiteti i Menaxhimit të Aktiveve dhe Detyrimeve" (ALCO).

3.2.1 Rreziku i kurseve të këmbimit

Forma më e shpeshtë e rrezikut të monedhës është rasti kur Banka ka një pozicion valutor të hapur që do të çonte në humbje për shkak të ndryshimit të kursit të këmbimit dhe ndryshimit të vlerës së lekut në krahasim me monedhat e tjera. Në fund të çdo ditë pune banka rregullon pozicionin e saj të hapur valutor, duke pasur kujdes që të mos tejkalohen kufijtë e caktuar. Banka siguron se ekspozimi neto mbahet në një nivel të pranueshëm duke shitur dhe blerë valutë të huaj kur është e nevojshme për të rregulluar zbalancimet afatshkurtra.

Veneto Banka Sh.A.**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare***(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)***3 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****3.2 Rreziku i tregut (vazhdim)****3.2.1 Rreziku i kurseve te këmbimit (vazhdim)**

Kufijtë e vendosur nga enti rregullator apo politikat e grupit, janë të monitoruara çdo ditë nga menaxhimi i rrezikut, duke siguruar që autorizimet e nevojshme janë marrë në kohë nga strukturat kompetente në rast të ndonjë tejkalimi.

Përqendrimet e rrezikut të kursit të këmbimit – instrumentet financiare brënda dhe jashtë bilancit:

Më 31 dhjetor 2015	EUR	USD	Monedha të tjera	Lekë	Totali
Aktive					
Mjete monetare dhe ekuivalente	3,028,327	530,833	13,053	1,903,483	5,475,696
Rezerva e detyrueshme	1,019,970	86,271	-	872,829	1,979,069
Kredi dhe paradhënie klientëve	12,115,600	259,890	20	3,562,642	15,938,152
Investime financiare të mbajtura deri në maturim	-	-	-	-	-
Investime financiare të mbajtura për shitje	-	-	-	568,936	568,936
Aktive të tjera financiare	40,072	-	-	22,085	62,157
Totali i aktiveve financiare	16,203,968	876,994	13,074	6,929,974	24,024,011
Zërat jashtë bilancit	2,141,379	61	-	133,979	2,275,418
Detyrimet					
Detyrime për bankat	1,517,666	31	-	0	1,517,698
Detyrime për klientet	10,864,248	903,524	8,744	9,560,121	21,336,637
Detyrime të tjera financiare	103,590	1,031	-	12,539	117,160
Totali i detyrimeve financiare	12,485,504	904,586	8,744	9,572,660	22,971,494
Zërat jashtë bilancit	34,573,411	-	-	2,679,537	37,252,948
Pozicioni monetar neto i bilancit	3,718,465	(27,592)	4,329	(2,642,686)	1,052,516
Pozicioni monetar neto jashtë bilancit	(32,432,032)	61	-	(2,545,558)	(34,977,530)

Më 31 dhjetor 2014	EUR	USD	Monedha të tjera	Lekë	Totali
Aktive					
Mjete monetare dhe ekuivalente	2,079,970	722,156	20,421	1,381,420	4,203,967
Rezerva e detyrueshme	976,951	66,374	-	840,674	1,883,999
Kredi dhe paradhënie klientëve	13,877,067	321,642	-	3,070,695	17,269,404
Investime financiare të mbajtura deri në maturim	-	-	-	9,987	9,987
Investime financiare të mbajtura për shitje	-	-	-	2,132,071	2,132,071
Aktive të tjera financiare	28,866	508	-	28,545	57,919
Totali i aktiveve financiare	16,962,854	1,110,680	20,421	7,463,392	25,557,347
Zërat jashtë bilancit	3,046,936	299,092	-	570,918	3,916,946
Detyrimet					
Detyrime për bankat	701,852	29	-	-	701,881
Detyrime për klientet	10,968,859	1,129,444	4,273	9,827,118	21,929,694
Detyrime të tjera financiare	105,362	22,433	-	30,708	158,503
Totali i detyrimeve financiare	11,776,073	1,151,906	4,273	9,857,826	22,790,078
Zërat jashtë bilancit	37,586,364	-	-	1,552,372	39,138,736
Pozicioni monetar neto i bilancit	5,186,781	(41,226)	16,148	(2,394,434)	2,767,268
Pozicioni monetar neto jashtë bilancit	(34,539,428)	299,092	-	(981,454)	(35,221,789)

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

3 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**3.2 Rreziku i tregut (vazhdim)****3.2.1 Rreziku i kurseve të këmbimit (vazhdim)**

Analiza e ndjeshmërisë e pasqyruar në tabelën më poshtë, paraqet ndikimin tek fitimi para tatimit për periudhën, kur monedha e huaj vlerësohet 5% dhe 10% më shumë/pak. Banka menaxhon ekspozimin ndaj monedhës së huaj duke konsideruar që kapitali i nënshkruar dhe primi janë të shprehura në EUR.

Analiza e ndjeshmërisë 31 dhjetor 2015	USD	EUR	Monedha të tjera
Lek zhvlerësuar me 5%	(185,923)	1,380	(216)
Lek zhvlerësuar me 10%	(371,847)	2,759	(433)
Lek vlerësuar me 5%	185,923	(1,380)	216
Lek vlerësuar me 10%	371,847	(2,759)	433

Analiza e ndjeshmërisë 31 dhjetor 2014	USD	EUR	Monedha të tjera
Lek zhvlerësuar me 5%	(259,339)	2,061	(807)
Lek zhvlerësuar me 10%	(518,678)	4,123	(1,615)
Lek vlerësuar me 5%	259,339	(2,061)	807
Lek vlerësuar me 10%	518,678	(4,123)	1,615

Më 31 dhjetor 2015 në qoftë se Leku do të ishte zhvlerësuar/vlerësuar nga pikë bazë 5% më i lartë/ulët me të gjithë variablat e tjerë të mbajtur konstante, fitimi para tatimit i Bankës për periudhën dymbëdhjetë mujore mbyllur më 31 dhjetor 2015 përkatësisht do të rritej/ulej me përafërsisht 4,821 mijë Lekë (2014: 75,049 mijë Lekë).

3.2.2 Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit vlerëson ndikimin potencial të ndryshimeve të papritura në normën e interesit me impakt në te fitimin dhe kapitalin aksioner të Bankës; Ky rrezik zakonisht shfaqet në zërat e Librin Bankar. Objektivat për tu ndjekur që do të mbështesin procesin e saktë të kontrollit të rrezikut ndaj normes interesit janë:

- të ruajë stabilitetin e marzhit të interesit, duke minimizuar ndikimin negativ të ndryshimeve të normës (Perspektivat e marzhit të fitimit aktual) në një perspektivë të fokusuar kryesisht në afat të shkurtër. Stabiliteti i marzhit të interesit është i ndikuar kryesisht nga rreziku i rivlerësimit, rreziku i kurbës së kthimit, rreziku normës bazë dhe rreziku opsional;
- për të imunizuar vlerën financiare, marrë si shuma e vlerës aktuale të flukseve të pritshme të mjeteve monetare të gjeneruara nga të dyja anët e bilancit, perspektivat e vlerës financiare në krahasim me ato për fitime aktuale duhet të shihet në plan afatmesem e të gjatë dhe është e lidhur kryesisht me Rrezikun e rivlerësimit; Banka monitoron me baza mujore 2 tregues (luhatja e supozuar +/- 1%) mbi normën e interesit:
- raporti i marzhit të interesit delta dhe marzhi i interesit të pritshëm të vlerësuar për vitin aktual.
- raporti midis vlerës ekonomike delta dhe kapitalit rregullator.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

(Të gjitha shumatat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

3 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

3.2 Rreziku i tregut (vazhdim)

3.2.2 Rreziku i normës së interesit (vazhdim)

Ruajtja e rrezikut të normës së interesit dhe rrezikut të mospërputhjeve të maturimit janë nën përgjegjësinë e Komitetit të Manaxhimit të "Akteve dhe Detyrimeve" (ALCO) e cila mban nën monitorim të vazhdueshëm e të repte strukturën e aktiveve dhe detyrimeve të Bankës, duke u siguruar që të vëzhgojë efektet dhe përmasat e çdo lloji ndryshimi të faktorëve të brendshëm apo të jashtëm, të tregut ose rregullatorë. Banka është më e rriten me një përqindje më të ulët në krahasim me normat e interesit, marzhet e fituara do të rriten sepse normat e interesit të detyrimeve do të duke përfshirë edhe stabilitetin e ekonomisë, mjedisin dhe nivelin e inflacionit. Megjithatë ndikimi aktual do të varet nga faktorë të ndryshëm, aktivet dhe detyrimet e bankës. Aktivet dhe detyrimet me norma të ndryshueshme janë raportuar në bazë të datës së ardhshme të interesit për normës. Aktivet dhe detyrimet me normë fikse janë raportuar në bazë të datave të pagesave të skeduluara të principalit:

Më 31 dhjetor 2015	Deri në 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Mbi 1 vit	Nuk sjellin interes	Totali
Aktivët						
Mjetet monetare dhe ekuivalente	5,154,905	-	-	-	-	5,154,905
Rezerva e detyrueshme	872,829	-	-	-	320,791	5,475,696
Kredi dhe paradhënie për klientët	6,094,310	428,658	1,786,903	9,433,261	1,106,241	1,979,069
Investime financiare të mbajtura deri në maturim	-	-	-	-	(1,804,980)	15,938,152
Investime financiare të mbajtura për shitje	214,594	212,849	141,493	-	-	-
Aktive të tjera financiare	-	-	-	-	-	568,936
Totali i aktiveve financiare	12,336,638	641,507	1,928,396	9,433,261	(315,791)	62,157
Detyrimet						
Detyrime për bankat	279,811	-	-	-	-	1,517,698
Detyrime për klientët	6,218,202	1,900,886	9,185,926	4,015,826	15,798	21,336,637
Detyrime të tjera financiare	-	-	-	-	117,160	117,160
Totali i detyrimeve financiare	6,498,013	1,900,886	10,423,812	4,015,826	132,957	22,971,494
Hendeku i ndjeshmërisë së interesit	5,838,624	(1,259,379)	(8,495,416)	5,417,435	(448,748)	1,052,516

Veneto Banka Sh.A.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

(Të gjitha shumatat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

3 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

3.2 Rreziku i tregut (vazhdim)

3.2.2 Rreziku i normës së interesit (vazhdim)

Tabela e mëposhtme përfaqëson zërat të periudhës krahasuese:

Më 31 dhjetor 2014	Deri në 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Mbi 1 vit	Nuk sjellin interes	Totali
Aktivet						
Mjetet monetare dhe ekuivalente	4,203,967	-	-	-	-	4,203,967
Rezerva e detyrueshme	840,674	-	-	-	1,043,325	1,883,999
Kredi dhe paradhënie për klientët	6,344,996	304,087	2,299,980	9,384,021	(1,063,680)	17,269,404
Instrumente financiare të mbajtura deri në maturim	9,987	-	-	-	-	9,987
Instrumente financiare të mbajtura për shitje	310	4,558	1,006,017	1,121,186	-	2,132,071
Aktive të tjera financiare	-	-	-	-	57,919	57,919
Totali i aktiveve financiare	11,399,934	308,645	3,305,997	10,505,207	37,564	25,557,347
Detyrimet						
Detyrime për bankat	43	701,838	-	-	-	701,881
Detyrime për klientët	7,398,292	2,243,439	9,730,874	2,541,568	15,521	21,929,694
Detyrime të tjera financiare	-	-	-	-	158,503	158,503
Totali i detyrimeve financiare	7,398,335	2,945,277	9,730,874	2,541,568	174,024	22,790,077
Hendeku i ndjeshmërisë së interesit	4,001,599	(2,636,632)	(6,424,877)	7,963,639	(136,460)	2,767,270

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare*(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)***3 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****3.2 Rreziku i tregut (vazhdim)****3.2.2 Rreziku i normës së interesit (vazhdim)**

Analiza e ndjeshmërisë, më poshtë është përcaktuar bazuar në ekspozimin ndaj normave të interesit në datën e raportimit. Më 31 dhjetor 2015, nëse normat e interesave do të rriten ose zvogëlohen me 1% , me gjithë variablat të mbajtura të pa ndryshuara, fitimi para tatimit i bankës për periudhën 12 mujore do të zvogëlohet/rritet respektivisht afërsisht me Lekë 13,601 mijë (2014: Lekë 11,002 mijë).

Analiza e ndjeshmërisë së normës së interesit paraqitet më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Norma e interesit rritet me 2%	27,202	(22,005)
Norma e interesit rritet me 1%	13,601	(11,002)
Norma e interesit rritet me 1%	(13,601)	11,002
Norma e interesit rritet me 2%	(27,202)	22,005

Rreziku i normës së interesit monitorohet edhe në bazë të Udhëzimit të Bankës së Shqipërisë "për menaxhimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës", i cili përcakton kufi për ndryshimin në ekspozimin e librit bankar ndaj 20% të kapitalit rregullator pas një shoku (luhajte) 200 pikë bazike të kurbës së normës interesit. Treguesi i bankes për dhjetor 2015 është në nivelin 10.06% kundrejt kapitalit rregullator.

3.3 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që banka nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e saj për pagesat në maturim (të pritshme dhe jo të pritshme) dhe kërkesat për kolateral, sipas kritereve ekonomike, pa prekur veprimet ditore ose gjendjen financiare të vetë bankës. Rreziku i financimit me likuiditet mund të shkaktojë reaksione shumë të shpejta nga homologët e tregut, me të cilët bëhen veprimet ndërbankare të zakonshme, ose kërkojnë në këmbim një çmim më të lartë.

Një politikë për menaxhim i rrezikut të likuiditetit është zbatuar në të gjitha njësitë e Bankës që nga fundi i dhjetor 2010, e cila rishikohet çdo vit nga ana e grupit. Kjo politikë rregullohet me praktikën e aplikuara ndërkombëtarisht me kushte rregulluese dhe përshtatet për aktivitetet specifike të Veneto Banca Scpa.

Politika përcakton përkufizimet kryesore të rrezikut të likuiditetit dhe metodave të vlerësimit, përcakton rolet dhe përgjegjësitë e njësive dhe stafit të përfshirë dhe përcakton udhëzimet për menaxhimin e krizave të likuiditetit. Politika është e fokusuar në nevojat e likuiditetit që pritet të dalin në një javë ose një muaj kohë, në bazë të skenarëve hipotetikë të krizë së likuiditetit.

Për më tepër, politika e përcakton një plan financimi për ngjarje ekstreme (të pazakonta) që do të përdoret në rastin e një krize likuiditeti. Një krizë e tillë mund të ndodhë për shkak të një ngjarjeje të veçantë në Veneto Banka ose një situatë të përgjithshme të tregut. Sinjalet paralajmëruese shërbejnë si tregues kur duhet të vihet në veprim plani i emergjencës. Ky plan emergjence është i bazuar kryesisht në financimin shtesë që do të marrë me kërkesë nga banka mëmë.

3 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

3.3 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Menaxhimi operativ i likuiditetit është nën përgjegjësinë e Departamentit të Thesarit. Likuiditeti monitorohet në baza ditore nga Plani Ditor i Likuiditetit dhe në baza javore. ALCO është përgjegjëse për menaxhimin e aktiveve likuide të Bankës dhe projektimin e strategjisë së bankës në zhvillimin e aseteve dhe detyrimeve.

Banka merr kujdesin e duhur të përputhet me kërkesat e rezervës minimale të vendosura nga Banka Qendrore dhe monitoron treguesit e likuiditetit, "aktivet likuide / pasivët afatshkurtra", ashtu siç është përcaktuar në Rregulloren e Bankës Shqipërisë, e cila i referohet kuadrit të kontrollit të bankave 'mjaftueshmërisë së likuiditetit. Nivelet e këtyre treguesëve janë të monitoruar në baza javore nga Thesari dhe Departamenti i Rrezikut dhe janë të përfshira në raportin ALCO. Nuk ka shkelje të këtyre kufijve gjatë 2014.

Banka përdor për qëllime të brendshme të menaxhimit të rrezikut likuiditetit edhe tregues të tjere siç përshkruhet më poshtë:

- Hendeku aktiv neto i likuiditetit, për një periudhë 3 mujore në krahasim me aktivet në total dhe për çdo monedhë.
- Banka Mëmë monitoron edhe likuiditetin strukturor (treguesit mbi 1 vit dhe mbi 3 vjet) në baza mujore.
- Stress-testi kryhet çdo tre muaj nga ana e Departamentit të Rrezikut i cili monitoron edhe përputhshmërinë me treguesit e likuiditetit të përcaktuara nga Banka Qendrore e Shqipërisë.

3.3.1 Proçesi i menaxhimit të rrezikut të likuiditetit

Në përgjithësi, menaxhimi i likuiditetit është çështje e balancimit të flukseve të parasë në grupime kohore rritëse, në mënyrë që në kushte normale, banka të vendoset në një pozicion që mund të përmbushë të gjitha detyrimet e saj të pagesave sipas afateve të tyre.

Analiza e hendekut të likuiditetit ofron një pasqyrë të flukseve të pritshme të parasë, të cilat rrjedhin nga të gjitha aktivet e bilancit. Flukset e mjeteve monetare janë grumbulluar dhe përcaktuar në bazë të kohës kur ato ndodhin.

Tabela e mëposhtme analizon aktivet dhe detyrimet në periudhat kohore përkatëse bazuar në periudhën e mbetur në datën e raportimit deri në datën kontraktuale të maturimit. Aktivët dhe detyrimet në valutë të huaj janë konvertuar në lekë, duke përdorur normat e kursit të këmbimit të fundit të vitit.

Supozimet e bëra janë që pagesat e planifikuara për bankën respektohen plotësisht dhe në kohën e duhur dhe për më tepër, të gjitha pagesat kontraktuale kryhen plotësisht – për shembull: depozituesit do të tërheqin paratë e tyre në vend që t'i rivendosin në bankë në datën e maturimit. Ato aktive dhe detyrime që faktikisht nuk kanë maturitete (për shembull llogari të hapura, llogari rrjedhëse, llogari kursimi) përfshihen në grupin kohor me pak se një muaj.

Veneto Banka Sh.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

3 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

3.3 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

3.3.1 Procesi i menaxhimit të rrezikut të likuiditetit (vazhdim)

Më 31 dhjetor 2015	Deri në 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Nga 1 deri në 5 vjet	Mbi 5 vjet	Totali
Aktivët						
Mjetet monetare dhe ekuivalente	5,475,696	-	-	-	5,475,696	5,475,696
Rezerva e detyrueshme	349,049	-	-	-	1,630,020	1,979,069
Kredi dhe paradhënie për klientët	4,341,989	460,349	1,888,316	5,871,432	3,376,067	15,938,152
Instrumente financiare të mbajtura deri në maturim	-	-	-	-	-	-
Instrumente financiare të mbajtura për shitje	214,594	212,849	141,493	-	-	568,936
Aktive të tjera financiare	62,157	-	-	-	-	62,157
Totali i aktiveve financiare	10,443,486	673,197	2,029,809	5,871,432	5,006,087	24,024,011
Zërat jashtë bilancit	264,730	54,120	1,132,066	755,862	68,640	2,275,418
Detyrimet						
Detyrime ndaj bankave	5,251	-	2,366	1,510,080	-	1,517,698
Detyrime ndaj klientëve	6,218,202	1,900,886	9,185,926	4,004,453	27,170	21,336,637
Detyrime të tjera financiare	117,160	-	-	-	-	117,160
Totali i detyrimeve financiare	6,340,613	1,900,886	9,188,292	5,514,533	27,170	22,971,494
Zërat jashtë bilancit	4,178,369	137,546	622,224	3,613,464	31,666,593	40,218,196
Hendeku neto i likuiditetit	4,102,873	(1,227,689)	(7,158,483)	356,899	4,978,917	1,052,516
Hendeku neto i likuiditetit brenda dhe jashtë bilancit	189,234	(1,311,114)	(6,648,642)	(2,500,703)	(26,619,036)	(36,890,261)

Veneto Banka Sh.A.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

3 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

3.3 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

3.3.1 Procesi i menaxhimit të rrezikut të likuiditetit (vazhdim)

Të gjitha llogaritë rrjedhëse të klientëve përfshihen në detyrime që maturojnë për më pak se një muaj. Çdo çështje që vjen si pasojë e mospërputhjes së likuiditetit menaxhohet me veprimet ndërbankare (huamarrjes, huadhënies) të linjave të miratuara të kredisë. Tabela e mëposhtme përfshin zërat të periudhës krahasuese:

Më 31 dhjetor 2014	Deri në 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Nga 1 deri në 5 vjet	Mbi 5 vjet	Totali
Aktivët						
Mjetet monetare dhe ekuivalente	4,203,967	-	-	-	-	4,203,967
Rezerva e detyrueshme	336,168	-	-	-	1,547,831	1,883,999
Kredi dhe paradhënie për klientët	3,704,024	352,741	1,676,214	2,392,247	9,144,178	17,269,404
Instrumente financiare të mbajtura deri në maturim	9,987	-	-	-	-	9,987
Instrumente financiare të mbajtura për shitje	4,557	2,718	1,568,610	556,186	-	2,132,071
Aktive të tjera financiare	57,919	-	-	-	-	57,918
Totali i aktiveve financiare	8,316,622	355,459	3,244,824	2,948,433	10,692,009	25,557,347
Detyrimet	1,131,049	704,951	1,230,297	325,125	525,525	3,916,946
Detyrime ndaj bankave	-	-	-	-	-	-
Detyrime ndaj klientëve	6,176,927	-	252,304	447,767	-	700,071
Detyrime të tjera financiare	158,503	591,521	10,441,529	5,069,141	-	22,279,118
Totali i detyrimeve financiare	6,335,430	591,521	10,693,833	5,516,908	-	158,503
Zërat jashtë bilancit	3,074,717	803,048	1,780,705	2,674,965	30,833,329	39,166,764
Hendeku neto i likuiditetit brenda dhe jashtë bilancit	832,393	(1,903,076)	(6,775,924)	(55,946)	10,669,821	2,767,268

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

3 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

3.3 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

3.3.2 Zërat jashtë bilancit

Letër kreditë dhe letër garancitë e dhëna për klientët angazhojnë bankën të kryejë pagesa në favor të klientëve të cilat janë të kushtëzuara me dështimin e klientit për të vepruar sipas kushteve të kontratës.

Angazhimet për të dhënë kredi përfaqësojnë detyrimet kontraktuale për të dhënë kredi të ripërtëritshme. Angazhimet në përgjithësi kanë datat e skadimit të përcaktuara, ose dispozita të tjera të përfundimit.

3.3.3 Rreziku Operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjes që rezulton nga proceset e brendshme të papërshtatshme apo të dështuara, për shkak të njerëzve dhe sistemeve ose nga ngjarjet e jashtme. Ky përkufizim përfshin rrezikun ligjor, por përjashton rrezikun reputacional dhe strategjik. Banka ka identifikuar Personat kryesore në çdo degë / departament përgjegjës për raportimin e ngjarjeve të rrezikut operacional. Gjithashtu gjatë 2014 një proces i vetë-vlerësimit të rrezikut operacional është ndërmarrë për aktivitetet kryesore që kontribuojnë në krijimin e një kulture të vetëdijes rrezikut brenda bankës.

Një humbje materiale e rrezikut operacional është konsideruar 1% e fitimit bruto të buxhetit bankës, dhe njësia e rrezikut menjëherë njofton drejtori ekzekutiv dhe Bordin e Drejtorëve. Banka ka miratuar rregulloren modifikuar të Politikës rrezikut operacional në përputhje me rekomandimet e Mbikëqyrësit dhe politiken tonë të Grupit të dhjetorit 2013. Nga dhjetori 2014 sipas Udhëzimeve të Bankës së Shqipërisë, banka llogarit kapital rregullator për rrezikun operacional.

3.3.4 Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare

Matjet e vlerës së drejtë analizohen nga niveli në hierarkinë e vlerës së drejtë si më poshtë:

(i) niveli 1 janë matje me çmime të kuotuar (të parregulluara) në tregjet aktive për aktive dhe pasive identike;

(ii) niveli 2 i matjeve janë teknikat e vlerësimeve që përdorin të gjitha inputet të vëzhgueshme për aktivin ose pasivin, në mënyrë të drejtpërdrejtë (sic janë çmimet) ose indirekt (sic janë, ato që rrjedhin nga çmimet); dhe

(iii) niveli 3 i matjeve janë vlerësimet jo të bazuara në të dhëna të vëzhgueshme në treg (pra, inpute jo të vëzhgueshme).

Menaxhimi aplikon gjykimin në kategorizimin e instrumenteve financiare duke përdorur hierarkinë e vlerës së drejtë. Nëse një matja e vlerës së drejtë përdor të dhëna të vëzhgueshme që kërkojnë rregullim të rëndësishëm, ajo matja është e Nivelit të 3. Rëndësia e një input vlerësimi, vlerësohet kundrejt matjes së vlerës së drejtë në tërësi. Matjet e vlerës së drejtë të janë ato që standardet e kontabilitetit kërkojnë ose e lejohen në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të çdo periudhe raportuese.

Veneto Banka Sh.A.**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare***(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)***3 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****3.3 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)****3.3.4 Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare (vazhdim)**

Vlera e drejtë e analizuara nga niveli i hierarkisë së vlerës së drejtë dhe mbajta e vlerës së aktiveve jo të matura me vlerën e drejtë janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2015			
	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
AKTIVET FINANCIARE				
Kredi dhe paradhënie për bankat	-	-	1,979,069	1,979,069
Kredi dhe paradhënie për klientët	-	-	14,702,516	14,702,516
Instrumente financiare të mbajtura në maturim	-	-	-	-
Instrumente financiare të mbajtura për shitje	-	568,936	-	568,936
DETYRIMET FINANCIARE				
Detyrime ndaj klientëve	-	-	21,333,222	21,333,222
Detyrime ndaj bankave	-	-	1,517,698	1,517,698
Garancitë			69,639	69,639

	31 dhjetor 2014			
	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
AKTIVET FINANCIARE				
Kredi dhe paradhënie për bankat	-	-	1,883,999	1,883,999
Kredi dhe paradhënie për klientët	-	-	17,319,879	17,319,879
Instrumente financiare të mbajtura në maturim	-	9,987	-	9,987
Instrumente financiare të mbajtura për shitje	-	2,132,071	-	2,132,071
DETYRIMET FINANCIARE				
Detyrime ndaj klientëve	-	-	16,685,279	16,685,279
Detyrime ndaj bankave	-	-	703,340	703,340
Garancitë			62,918	62,918

a) Kreditë dhe paradhëniet për bankat

Kredi dhe paradhënie për bankat përfshijnë vendosje ndërbankare. Vlera e drejtë e vendosjeve me normë të pandryshueshme dhe depozitat njëditore është e barabartë me vlerën e tyre kontabël. Llogaritja e vlerës së drejtë e depozitave me norma të pandryshueshme interesi bazohet në flukset monetare të skontuara duke përdorur normat e interesit që mbizotërojnë në treg për borxhet me rrezik kreditimi dhe maturitet të mbetur të ngjashëm. Në lidhje me depozitat në institucionet e kredisë, këto janë depozita afatshkurtra, për të cilat interesi që bartin nuk ndryshon shumë nga normat e interesit të tregut më 31 dhjetor.

b) Kreditë dhe paradhëniet për klientët

Kreditë dhe paradhëniet nuk përfshijnë zhvlerësimin. Portofoli i kredisë i bankës ka një vlerë të drejtë të llogaritur më të vogël se vlera kontabël për shkak të normave të interesit më të larta mbizotëruese në treg në fund të 2014. Pjesa më e madhe e portofolit të kredive është subjekt riçmimi-brenda një viti.

Vlera e drejtë e kredive dhe paradhëniet për klientët është fluksi i prituri i skontuar me normat aktuale të tregut. Normat aktuale të tregut janë normat e interesit që do të aplikoheshin në këtë moment (në fund të vitit).

Vlera e drejtë e depozitave pa afat, e cila përfshin depozitat jo të ndjeshme ndaj normës së interesit, është një shumë e ripagueshme bazuar në kërkesë.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

3 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

3.3 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

3.3.4 Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare (vazhdim)

c) Detyrime për bankat dhe klientët, depozita të tjera dhe huamarrje të tjera

Vlera e drejtë e përllogaritur e depozitave me norma interesi të pandryshueshme dhe huamarrje të tjera të pakuotuar në një treg aktiv bazohet në flukset e skontuara të parasë duke përdorur norma interesi për borxh të ri me maturitet të mbetur të ngjashëm. Vlera kontabël ndryshon nga vlera e drejtë sepse normat e interesit janë më të larta se normat e tregut më 31 dhjetor 2014, pasi në fund të vitit bankat ofrojnë norma më të larta interesi duke konkurruar për të rritur numrin depozitave.

Detyrimet për bankat i referohet kredive të marra nga mëma me një afat maturimi prej 6-18 muaj nga data e bilancit dhe për këtë arsye vlera e tyre e drejtë konsiderohet të jetë e përafërt me vlerën kontabël.

d) Instrumente financiare të mbajtura deri në maturim

Vlera e drejtë e instrumenteve të mbajtura deri në maturim përcaktohet duke përdorur çmime të kuotuar për instrumente të ngjashme me normën që nevojitet për aktualizimin e flukseve të ardhshme në datën e raportimit. Investime të tilla janë afat – shkurtra, dhe përsëri norma e interesit nuk ndryshon shumë nga norma e tregut më 31 dhjetor 2014.

e) Instrumente financiare të vlefshme për shitje

Vlera e drejtë e instrumenteve të mbajtura për shitje përcaktohet duke përdorur çmime të kuotuar për instrumente të ngjashme.

3.4 Manaxhimi i kapitalit

Objektivat e Bankës për manaxhimin e kapitalit, i cili është një koncept më i gjerë sesa "kapitali" në bilanc, janë:

- Të jetë në përputhje me kërkesat e kapitalit të vendosura nga Banka e Shqipërisë;
- Të ruaj aftësinë e bankës për të vazhduar në vijimësi në mënyrë që të mund të vazhdojë të sigurojë kthim për aksionerët dhe përfitime për grupet e tjera të interesit, dhe
- Të ruaj një bazë të kapitalit të fortë për të mbështetur zhvillimin e biznesit të saj.

Mjaftueshmëria e kapitalit dhe përdorimi i kapitalit rregullator janë të monitoruara çdo ditë nga drejtuesit e Bankës, duke përdorur teknika të bazuara në udhëzimet e zhvilluara nga Komiteti i Baselit dhe Direktivat e Komunitetit Evropian, ashtu siç janë implementuar nga Banka e Shqipërisë, për qëllime të mbikëqyrjes. Informacioni i kërkuar dërgohet në Bankën e Shqipërisë çdo tre muaj.

Banka e Shqipërisë kërkon që çdo bankë ose grup bankar: (a) të mbajë nivelin minimal të kapitalit rregullator prej 1 miliardë Lekë dhe (b) të mbajë një raport të totalit të kapitalit rregullator përmbi aktivet e ponderuara me rrezik ('raporti Basel') deri në ose mbi minimumin e pranuar në nivel ndërkombëtar prej 12%.

Kapitali rregullator i bankës, ashtu siç menaxhohet nga Departamenti i Rrezikut të bankës, është i ndarë në dy nivele:

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

3 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**3.4 Menaxhimi i kapitalit (vazhdim)**

- **Kapitali bazë:** kapitali aksionar (duke i zbritur vlerat kontabël të aksioneve të thesarit), fitimi i mbartur dhe rezervat e krijuara si përpjesëtim i fitimit të mbartur; dhe rezervave të rivlerësimit statutore;
- **Kapitali shtesë:** borxhi i varur që kualifikohet si kapital dhe fitimet e perealizuara nga vlerësimi i drejtë i instrumenteve të kapitalit dhe borxhit të mbajtura si të disponueshme për shitje.

Aktivet e ponderuara me rrezik maten sipas një hierarkie prej katër ponderimesh rreziku të klasifikuara sipas natyrës – dhe duke pasqyruar një vlerësim të risqeve përkatës të kredisë, tregut dhe risqeve të tjera – çdo aktiv dhe palë e trete, duke marrë parasysh kolateralët apo garancitë e përshtatshme. Një trajtim i ngjashëm përdoret për ekspozimin jashtë bilancit me disa rregullime për të pasqyruar natyrën e kushtëzuar të humbjeve të mundshme.

Tabela në vijim përmbledh përbërësit e kapitalit rregullator dhe raportet e bankës për vitet e mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2014. Gjatë këtyre dy viteve, Banka ka qenë në përputhje me të gjitha kërkesat e jashtme në lidhje me kapitalin ndaj të cilave është subjekt.

Zbritjet përfaqësojnë humbjet statutore të akumuluar dhe aktivet afatgjata jomateriale.

Norma e mjaftueshmerisë së kapitalit	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Kapitali bazë		
Kapital aksionar	4,731,376	4,731,376
Rezerva ligjore	19,358	19,358
Diferenca rivlerësimi për qellime raportimi ndaj Bankës së Shqipërisë	88,353	188,764
Nëntotali 1	4,839,088	4,939,498
Kapitali shtesë		
Detyrime të varura	-	-
Rezerva e rivlerësimit	-	-
Totali i kapitalit bazë dhe atij shtesë	-	-
Elementet përbërëse që zbriten	2,498,065	1,784,023
Totali i kapitalit rregullator	2,341,023	3,155,475
Zërat e aktivitetit të ponderuara me rrezik:		
Zërat brënda dhe jashtë bilanc	16,410,900	22,342,444
Shtesa	2,744,006	1,538,805
Pakesime	-	(2,695,382)
Total i zërave të aktivitetit të ponderuara me rrezik	19,154,906	21,185,867
Norma e mjaftueshmerisë së kapitalit	12.22%	14.89%

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit llogaritet duke u bazuar në informacionin financiar të përgatitur sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë, të shpjeguar më sipër.

4 Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël

Banka kryen vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë për ngjarje të ardhshme që mendohet se janë të arsyeshme në rrethanat aktuale.

Parimi i vijimësisë. Drejtimi ka përgatitur këto pasqyra financiare në bazën e parimit të vijimësisë. Në marrjen e këtij vendimi drejtimi ka marrë parasysh pozicionin financiar të Bankës, planet aktuale, fitimin nga operacionet dhe të drejtat ndaj burimeve financiare dhe ka analizuar efektin e kushteve aktuale makro-financiare në operacionet e ardhshme të Bankës.

Sipas Rregullores së Bankës së Shqipërisë, norma minimale e mjaftueshmërisë së kapitalit për Bankat duhet të jetë 12%. Më 31 dhjetor 2015, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit ishte 12,22% (2014: 14,89%). Për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2015 dhe 2014, Banka kishte një humbje neto prej 1,041,201 mijë Lekë dhe 530,548 mijë Lekë përkatësisht.

Aftësia e Bankës për të përmbushur detyrimet e saj dhe për të vazhduar në vijimësi varet nga fondet e aprovuara nga Shoqëria mëmë. Shoqëria mëmë ka deklaruar angazhimin e saj për të mbështetur Bankën duke marrë masat e mëposhtme:

Më 29 qershor 2016, Bordi i Drejtorëve të Shoqërisë mëmë ka aprovuar me anë të vendimit nr. 329, rritje të kapitalit në vlerën maksimale prej 30,003 mijë Euro (ekuivalente në Lekë 412,353 mijë konvertuar më kursin e këmbimit Euro/Lekë 137.19) përmes emetimit të një maksimumi prej 3,774 aksionesh të reja. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve pritet të ratifikojë vendimin e Bordit të Drejtorëve deri më 07 korrik 2016. Fondet priten të depozitohen në llogarinë e Bankës brenda muajit korrik 2016. Referojuni Shënimit 33 për Ngjarje pas datës së Raportimit.

Në bazë të kësaj, Drejtimi beson se aplikimi i parimit të vijimësisë është i përshtatshëm duke qënë se po merren gjithë masat e nevojshme për të mbështetur qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e aktivitetit të Bankës në kushtet e tanishme.

(a) Humbje nga zhvlerësimi i kredive dhe paradhënieve

Banka rishikon portofolin e saj të kredisë për të vlerësuar zhvlerësimin të paktën çdo muaj. Në përcaktimin nëse një humbje zhvlerësimi duhet të regjistrohet ose jo në fitim ose humbje, banka kryen gjykime nëse ekzistojnë të dhëna të dukshme që tregojnë se ka një rënie të matshme në vlerësimin e flukseve të ardhshme të parasë nga një portofol kredish para se rënia të identifikohet me një kredi individuale në po atë portofol. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna të dukshme që tregojnë se ka pasur një ndryshim të pafavorshëm në gjendjen e pagesave të kredimarrësve në një bankë, ose kushte kombëtare ose lokale ekonomike që lidhen drejtpërdrejtë me dështim të aktiveve në një bankë.

Drejtimi përdor vlerësime të bazuara në eksperiencën historike të humbjeve për aktivet me karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë dhe të evidencës objektive të zhvlerësimit në portofol kur projektohen flukset e ardhshme të parasë. Metodologjia dhe supozimet e përdorura për të vlerësuar si shumë ashtu edhe kohën e flukseve të ardhshme rishikohen rregullisht për të reduktuar çdo diferencë që ekziston midis vlerësimeve të humbjeve dhe eksperiencës faktike të humbjes.

Një rritje apo ulje prej 10% në humbjet faktike në krahasim me flukset e mjeteve monetare të përdorura do të rezultonte në një rritje ose ulje të humbjeve nga provigjoni prej 16,766 mijë Lekë (2014: 12,950 mijë Lekë) përkatësisht. Humbjet nga provigjioni për kreditë individualisht të rëndësishme bazohen në vlerësimet e flukseve monetare të skontuara për kreditë individuale. Një rritje apo ulje prej 10% në humbjet faktike në krahasim me flukset monetare të skontuara për kreditë individuale të rëndësishme, të cilat mund të lindin nga ndryshimet në shumat dhe kohën e flukseve të mjeteve monetare, do të rezultojë në një rritje të humbjeve nga zhvlerësimi i kredisë në 159,889 mijë Lekë (2014: 17,727 mijë Lekë) ose një rënie në humbje nga zhvlerësimi i kredisë në lekë 61,289 mijë Lekë (2013: 20,990 mijë Lekë), përkatësisht.

5 Adoptimi i standardeve të reja dhe interpretimet kontabël

Standardet e reja dhe interpretimet e mëposhtme u bënë efektive për Bankën që prej 1 janar 2015:

Ndryshimet në SNK 19 - "Kontributet e punonjësve" (publikuar në nëntor 2013 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2014).

Ndryshimi lejon njësitë ekonomike të njohin kontributet e punonjësve si ulje të kostos së shërbimit në periudhën në të cilën është dhënë shërbimi i punonjësit, në vend të shpërndarjes të kontributeve për periudhat e shërbimit, nëse shuma e kontributeve të punonjësve është e pavarur nga numri i viteve të shërbimit. Amendamenti nuk ka pasur ndonjë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës.

Përmirësimet vjetore në SNRF-të 2012 (publikuar në dhjetor 2013 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 korrik 2014).

Përmirësimet përbëhen nga ndryshimet në shtatë standarde. SNRF 2 u ndryshua për të sqaruar përkufizimin e një 'kondite kushtëzimi' dhe për të përkufizuar veçmas 'kushtin e performancës' dhe 'kushtin e shërbimit'. Amendamenti nuk ka pasur ndonjë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës. Ndryshimi hyn në fuqi për transaksionet e pagesave të bazuara në aksione për të cilat data e grantit është më ose pas 1 korrik 2014. SNRF 3 është ndryshuar për të sqaruar se (1) një detyrim për të paguar një shumë të kushtëzuar që plotëson përkufizimin e një instrumenti financiar të klasifikuar si një detyrim financiar ose si kapital neto, në bazë të përcaktimeve të SNK 32, dhe (2) të gjithë shumat e kushtëzuara të cilat nuk klasifikohen si kapital neto, të cilat mund të jenë financiare dhe jo-financiare, maten me vlerën e drejtë në çdo datë raportimi, me ndryshimet në vlerën e drejtë të njohura në fitim dhe humbje. Ndryshimet në SNRF 3 janë efektive për kombinimet e biznesit, ku data e blerjes është më ose pas datës 1 korrik 2015. SNRF 8 u ndryshua për të kërkuar (1) dhënien e informacioneve shpjeguese mbi gjykimet e bëra nga manaxhimi në segmentet operative të agreguara, duke përfshirë një përshkrim të segmenteve të cilat kanë qenë të agreguara dhe treguesve ekonomikë të cilat janë vlerësuar në përcaktimin se segmentet e agreguara ndajnë karakteristika të ngjashme ekonomike, dhe (2) një rakordim të aktiveve të segmentit me aktivet e njësisë ekonomike, kur raportohen aktivet e segmentit. Baza për përfundimet në SNRF 13 u ndryshua për të sqaruar se fshirja e disa paragrafëve të caktuar në SNK 39 me publikimin e SNRF 13 nuk është bërë me qëllim për të hequr aftësinë për të matur të llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme afatshkurtëra në shumën e faturës ku ndikimi i skontimit është jomaterial. SNK 16 dhe SNK 38 u ndryshuan për të sqaruar se si trajtohen vlera kontabël bruto dhe amortizimi i akumuluar kur njësia ekonomike përdor modelin e rivlerësimit. SNK 24 u ndryshua për të përfshirë si një palë të lidhur, një njësi ekonomike që ofron shërbimet e personelit kyç të manaxhimit të njësisë ekonomike raportuese ose mëmës së njësisë ekonomike raportuese (njësia manaxhuese'), dhe për të kërkuar të japë informacion mbi shumat e ngarkuara njësisë raportuese nga njësia manaxhuese për shërbimet e ofruara. Ndryshimi nuk ka pasur ndonjë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës.

5 Adoptimi i standardeve të reja dhe interpretimet kontabël (vazhdim)

Përmirësimet vjetore në SNRF-të 2013 (publikuar në dhjetor 2013 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 korrik 2014) Përmirësimet përbëhen nga ndryshimet në katër standarde. Baza për përfundimet në SNRF 1 u ndryshua për të sqaruar se, kur një version i ri i një standardi nuk është ende i detyrueshëm, por është i disponueshëm për adaptim të mëparshëm; adaptuesi për herë të parë mund të përdorë versionin e vjetër ose versionin e ri, me kusht që i njëjti standard të zbatohet në të gjitha periudhat e paraqitura. SNRF 3 u ndryshua për të sqaruar se nuk zbatohet për kontabilitetin për formimin e ndonjë marrëveshje të përbashkët sipas SNRF 11. Ndryshimi gjithashtu sqaron se përjashtimi nga objekti i standardit zbatohet vetëm në pasqyrat financiare të vetë marrëveshjes së përbashkët. Ndryshimi i SNRF 13 sqaron se përjashtimi nga portofoli në SNRF 13, i cili lejon një njësi ekonomike të masë vlerën e drejtë të një grupi aktivesh financiare dhe detyrimesh financiare mbi një bazë neto, zbatohet për të gjitha kontratat (përfshirë kontratat për të blerë ose shitur zërat jo-financiarë) që janë brenda objektit të SNK 39 ose SNRF 9. SNK 40 u ndryshua për të sqaruar se SNK 40 dhe SNRF 3 nuk janë reciprokisht përjashtuese. Udhëzimi në SNK 40 ndihmon përgatitësit të bëjnë dallimin midis aktivitetit afatgjatë material të investuar dhe pasurisë së zotëruar nga pronari. Përgatitësit gjithashtu duhet t'i referohen udhëzimeve në SNRF 3 për të përcaktuar nëse blerja e një aktivi afatgjatë material të investuar është një kombinim biznesi. Ndryshimi nuk ka pasur ndonjë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës.

6. Standardet e reja

Disa standarde dhe interpretime të reja, të cilat janë të detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2016, dhe të cilat Banka nuk i ka adoptuar më herët:

SNRF 9, "Instrumentet financiare" (publikuar në korrik 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2018). Pikat kryesore të standardit janë:

- Aktivitetet financiare duhet të klasifikohen në tre kategori matjeje: aktive të matura më pas me kosto të amortizueshme, aktive të matura më pas me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, dhe ato të matura më pas me vlerën e drejtë nëpërmjet fitim humbjes.
- Sqarimi i instrumenteve të huasë bazohet nga modeli i biznesit së njësisë në manaxhimin e aktiveve financiare dhe sipas faktit nëse flukset monetare kontraktuale rrjedhin kryesisht nga pagesat e interesit dhe primit. Nëse një instrument huaje është mbajtur për mbledhje, mund të mbartet me kosto të amortizuar nëse plotëson kushtet e pagesave të primit dhe interesave. Instrumentat e huasë që përmbushin këto kushte mbahen në një portofol ku një njësi mban dhe mbledh flukset monetare nga aktive dhe shet aktive që mund të klasifikohen me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit apo humbjes. Aktivitetet financiare që nuk përmbajnë pagesa për interesa apo prime duhet të maten me vlerën e drejtë në fitim apo humbje (për shembull, derivativë). Derivatet e përfshira nuk janë më të ndara nga aktivitetet financiare por do të përfshihen në vlerësimin e kushteve të pagesave të primit dhe interesave.
- Investimet në instrumentat kapitale maten gjithmonë me vlerë të drejtë. Drejtimi i Shoqërisë mund zgjedhë të paraqisë ndryshimet në vlerën e drejtë në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, me kusht që instrumenti mos të mbahet për qëllime tregtimi. Nëse instrumenti i kapitalit mbahet për qëllime tregtimi, ndryshimet në vlerën e drejtë paraqiten në pasqyrën e fitim humbjes.

6. Standardet dhe interpretimet e reja (vazhdim)

- Pjesa më e madhe e kërkesave të SNK 39 për klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare janë mbartur të pandryshuara sipas SNRF 9. Ndryshimi kryesor është që njësia duhet të paraqesë efektet e ndryshimeve në rrezikun kreditor të detyrimeve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë në të ardhurat gjithëpërfshirëse.
- SNRF 9 prezanton një model të ri të njohjes së humbjeve së zhvlerësimit – modelin e humbjeve të pritura të kreditit. Ka një qasje me tre faza e cila bazohet në ndryshimin e cilësisë së kreditit të aktivitetit financiar që nga njohja. Në praktikë, rregullat e reja parashikojnë që njësitet duhet të njohin një humbje direkte të barabarte me humbjet e pritura të kreditit për 12 muaj në njohjen fillestare të aktiveve financiare që nuk preken nga zhvlerësimi i kreditit (apo modeli i përhershëm i humbjeve të pritura të kreditit për llogaritë e arkëtueshme). Kur ka një rritje domethënëse në riskun e kreditit, zhvlerësimi matet me modelin e përhershëm në vend të modelit 12 muajsh. Ky model përfshin lehtësira operacionale për qeranë dhe llogaritë e arkëtueshme.
- Kërkesat e kontabilitetit mbrojtës janë rishikuar që të përshtatin më shumë kontabilitetin me manaxhimin e rrezikut. Standardi i jep njësive mundësi zgjedhje mes aplikimit e kërkesave të kontabilitetit të mbrojtës të SNRF 9 apo me aplikimin e SNK 39 sepse standardi momentalisht nuk adreson kontabilitetin makro të mbrojtjes.

Banka është duke vlerësuar ndikimin e standardit të ri në pasqyrat e saj financiare.

SNRF 15, Të ardhurat nga Kontratat me Klientët (publikuar më 28 maj 2014 dhe efektiv për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janar 2018). Standardi i ri prezanton parimin bazë se të ardhurat duhet të njihen kur mallrat ose shërbimet janë transferuar tek klientët, me çmimin e transaksionit. Çfarëdo mallra apo shërbime të paketuara të cilat janë të dallueshme duhet të njihen veçmas, dhe uljet apo zbritjet e çmimit duhet të ndahen nga elementët përkatëse. Kur pagesa ndryshon për ndonjë arsye, duhet të njihet një shumë minimale nëse nuk ka një rrezik domethënës për kthim. Shpenzimet e kryera për të siguruar kontrata me klientët duhet të kapitalizohen dhe amortizohen gjatë periudhës kur konsumohen përfitimet e kontratës.

Adoptimi i standardeve dhe interpretimeve të reja më poshtë nuk pritët të ketë efekte materiale për Bankën:

- SNFR 14, Llogaritë e shtyra (publikuar në janar 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2016).
- Kontabiliteti për blerjen e Interesave në operacione të përbashkëta - Ndryshimet në SNRF 11 (publikuar më 6 maj 2014 dhe në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janar 2016).
- Sqarimi i Metodave të pranueshme të Zhvlerësimit dhe Amortizimit - Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 38 (publikuar më 12 maj 2014 dhe në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016).
- Bujqësia: Bimët bartëse - Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 41 (publikuar më 30 qershor 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2016).
- Metoda e Kapitalit neto në pasqyrat financiare të veçanta - Ndryshimet në SNK 27 (publikuar më 12 gusht 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2016).
- Shitja apo kontributi i aktiveve ndërmjet një Investitori dhe pjesëmarrjes së tij ose të Sipërmarrjes përbashkët - Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 (publikuar më 11 shtator 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016).
- Përmirësimet vjetore në SNRF-të 2014 (publikuar më 25 shtator 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016).

Veneto Banka Sh.A.**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare***(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)***6. Standardet dhe interpretimet e reja (vazhdim)**

- Paraqitja e Ndryshimeve Fillestare të SNK 1 (publikuar në dhjetor 2014 dhe efektiv për periudhat vjetore më ose pas 1 janar 2016).
- Njësitë ekonomike investuese: Aplikimi i ndryshimit mbi përjashtimin e konsolidimit në lidhje me SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 28 (publikuar në dhjetor 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore për ose pas 1 janar 2016).

Përveç rasteve kur specifikohet ndryshe, standardet dhe interpretimet e reja nuk priten të ndikojnë në mënyrë materiale pasqyrat finance të Bankës.

7 Të ardhura nga interesi dhe të ngjashme

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura nga bankat duke përfshirë Bankën Qëndrore	35,543	63,570
Instrumente financiare të mbajtura deri në maturim	13	2,183
Instrumente financiare të vlefshme për shitje	69,937	99,585
Interesi nga kreditë me këste të klientëve	868,977	699,442
Interesi nga paradhëniet (overdraftet) e klientëve	384,000	455,835
	1,358,470	1,320,615

8 Shpenzime interesi dhe të ngjashme

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Detyrime ndaj bankave	43,908	30,839
Detyrime ndaj klientëve	398,537	570,988
	442,445	601,827

9 Të ardhura neto nga tarifat dhe komisionet

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Letër kredi	32,293	27,506
Transferta parash	65,204	48,849
Komision për mirëmbajtje llogarie	37,952	27,660
Tarifa të tjera të arkëtuara	30,843	18,370
Të ardhura totale nga tarifa dhe komisione	166,291	122,385
Karta krediti	(31,878)	(20,836)
Bankat korrespondente	(9,083)	(3,621)
Tarifa të tjera të paguara	(4,326)	(4,849)
Shpenzime totale nga tarifa dhe komisione	(45,287)	(29,306)
Të ardhura neto nga tarifa dhe komisione	121,005	93,079

Tarifa të tjera të arkëtuara përbëhen kryesisht nga komisionet mbi transaksionet me kartat VISA.

10 Fitime neto nga transaksionet në monedhë të huaj

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Fitim /(humbje) nga transaksionet në monedhë të huaj	46,297	33,017
Fitime/(humbje) nga kursi i këmbimit të përealizuara	(138,385)	4,384
	(92,088)	37,401

Veneto Banka Sh.A.**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare***(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)***11 Të ardhura të tjera**

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura të tjera operative	744	74
Shpenzime të tjera operative	-	-
	744	74

Të ardhura të tjera operative në 2015 përfshijnë të ardhurat nga shitja e aktiveve afatgjata të qëndrueshme.

12 Shpenzime për personelin

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Paga	199,361	195,693
Kontribut për fondin e pensioneve shtetërore	32,837	30,264
Shpenzime të tjera për personelin	1,342	2,782
	233,539	228,739

13 Shpenzime të përgjithshme të veprimtarisë

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shpenzime të qirasë operative	124,029	122,190
Shpenzime për siguri dhe mirëmbajtje	49,406	43,784
Shpenzime konsulence dhe legale	45,826	28,276
Reklama dhe marketing	15,186	21,910
Shpenzime për bordin ekzekutivë dhe jo ekzekutivë të drejtorëve	22,452	21,065
Kancelari dhe të konsumueshme	18,934	15,350
Shpenzime për Data Line	24,282	22,106
Shpenzime për shërbime bazë (utilitare)	15,064	12,056
Tarifa për sigurimin e depozitave (ASD)	42,776	32,685
Shpenzime telekomunikacioni	8,130	9,839
Shpenzime udhëtimi	5,358	5,042
Tarifa dhe shpenzime të ngjashme	5,946	4,055
Shpenzime të tjera sigurimi	5,186	6,255
Të tjera	1,757	2,543
Anëtarësime	77,923	44,927
	462,255	392,083

Të përfshira në shpenzimet e tjera është gjoba e vendosur nga inspektimi nga Autoriteti Tatimor Shqiptar të kryer gjatë 2015 për një shumë prej 68,447 mijë Lekë (2014: 27,887).

14 Shpenzimi i tatim fitimit

Përbërësit e shpenzimit të tatimit mbi të ardhurat janë si vijon:

	2015	2014
Tatimi aktual	-	-
Tatimi i shtyrë	5,256	4,785
Shpenzimi i tatim fitimit gjatë vitit	5,256	4,785

Norma e tatimi nga të ardhurat e aplikueshme për të ardhurat e bankës për 2014 është 15% (2014: 15%). Rakordimi midis tatimit të pritshëm dhe aktual është dhënë më poshtë:

Veneto Banka Sh.A.**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare***(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)***14 Shpenzimi i tatim fitimit (vazhdim)**

	Norma efektive e taksës	2015	Norma efektive e taksës	2014
Fitimi kontabël para tatimit		(1,043,855)		(521,450)
Norma teorike e tatimit (2015: 15%; 2014: 15%)		(156,578)		(78,218)
Efkti tatimor i zërave që nuk janë të zbritshme ose të njohura për qëllime tatimore:				
Kredi të fshira		4,020		4,903
Shpenzime të panjohura		15,050		9,753
Diferenca të lidhura me lindjen apo kthimin e diferencave të përkoreshme		132,252		58,777
Shpenzimi i tatim fitimit gjatë vitit	15%	(5,256)	15%	(4,785)

Tatim i shtyrë që përfshihet në bilanc dhe ndryshimet e regjistruara në pasqyrën e fitim ose humbjes janë si në vijim:

31 dhjetor 2015	Aktiv tatimor i shtyrë	Detyrim tatimor i shtyrë	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	Rezerva për rivlerësimin e aktiveve financiare të vlefshme për shitje
Instrumentet financiare të vlefshme për shitje	-	(14)	-	(14)
Rregullim i amortizimit për aktivet fikse	15,833	-	5,256	-
Totali	15,833	(14)	5,256	(14)
Aktiv tatimor i shtyrë	15,847			

31 dhjetor 2014	Aktiv tatimor i shtyrë	Detyrim tatimor i shtyrë	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	Rezerva për rivlerësimin e aktiveve financiare të vlefshme për shitje
Instrumente financiare të vlefshme për shitje	-	445	-	445
Rregullim i amortizimit për aktivet fikse	10,577	-	4,785	-
Totali	10,577	445	4,785	445
Aktiv tatimor i shtyrë	10,132			

Norma efektiveve tatimit për vitin 2015 është 15% (2014: 15%). Sipas legjislacionit tatimor shqiptar, autoritetet tatimore kanë të drejtë të inspektojnë një deklaram 5 vjet pas dorëzimit të tij. Menaxhimi nuk është në dijeni të ndonjë rrethane që mund të çojë në pagesa të rëndësishme të taksave dhe gjobave në të ardhmen, që nuk kanë qenë të parashikuara ose të shpalosura në pasqyrat financiare.

Veneto Banka Sh.A.**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare***(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)***15. Mjete monetare dhe gjendje me Bankën Qëndrore**

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Arka		
Kartëmonedha dhe monedha në Lekë	153,689	162,725
Kartëmonedha dhe monedha në monedhë të huaj	167,102	180,135
	320,791	342,860
Gjendje me Bankën Qëndrore		
Llogari rrjedhëse në Lekë	29,461	25,939
Llogari rrjedhëse në monedhë të huaj	65,953	120
	95,414	26,059
Nostro dhe llogari rrjedhëse me bankat		
Llogari korrespondente dhe depozita njëditore në bankat e tjera	2,810,371	2,664,817
Depozita në bankat e tjera me maturitet më pak se 3 muaj	2,249,120	1,170,231
	5,059,491	3,835,048
Totali i mjeteve monetare	5,475,696	4,203,967
	5,475,696	4,203,967
Afatshkurtër	-	-
Afatgjatë	153,689	162,725
Llogaritë rrjedhëse me Bankën Qendrore nuk bartin interes. Normat e interesit për llogaritë e tjera rrjedhëse janë të ndryshueshme. Cilësia e mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre paraqitet si më poshtë për periudhat deri më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:		
Standard & Poors, Moody's	2015	2014
Llogari Nostro dhe llogari rrjedhëse me bankat e huaja		
Raiffeisen Vienna	BBB 919,288	A- 931,421
Veneto Banca S.c.p.a	B+ 1,099,190	BB- 514,850
Monte dei paschi di Siena	B- 194,043	BBB 138,899
Banco Popolare Soc. Coop	Ba3 331,798	BBB 713,776
Banca Popolare Pugliese	- 8,979	- 298,803
Totali	2,553,298	2,597,749
Llogaritë Nostro dhe llogaritë rrjedhëse me bankat lokale		
Banka Kombetare Tregtare		-
Raiffeisen Bank	234,234	41,260
Procredit Bank Albania	22,839	25,807
Totali	257,073	67,067
Totali Llogaritë Nostro dhe llogaritë rrjedhëse me bankat	2,810,371	2,664,816

Normat e interesit për kreditë për bankat janë të pandryshueshme. Kreditë dhe paradhëniet për bankat lokale detajohen në tabelën në vijim:

Kredi dhe paradhënie për bankat e tjera	31 dhjetor 2015	31 December 2014
Banka Kombetare Tregtare	1,460,000	730,092
Societe Generale Bank	549,120	-
Union Bank	-	300,095
First Investment Bank	100,000	-
Banka Nderkombetare Tregtare	140,000	140,044
Totali	2,249,120	1,170,231

Veneto Banka Sh.A.**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare***(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)***16. Rezerva e detyrueshme**

Rezerva e detyrueshme janë të detajuara si në tabelën që vijon:

	31 dhjetor 2015	31 December 2014
Rezervat e detyrueshme në Bankën Qendrore		
Rezervat e detyrueshme në Lekë	872,624	840,420
Rezervat e detyrueshme në monedhë të huaj	1,106,241	1,043,325
	1,978,864	1,883,745
Interes i përlogaritur për depozitat në bankat e tjera	-	-
Interes i përlogaritur për rezervat e detyrueshme	205	254
Totali rezerva e detyrueshme	1,979,069	1,883,999
Afatshkurtër	349,049	336,168
Afatgjatë	1,630,020	1,547,831

Rezervat e detyrueshme me Bankën Qendrore nuk janë për përdorim të përditshëm nga Veneto Banka dhe përfaqësojnë një depozitë rezerve minimale, e cila kërkohet nga Banka Qendrore e Shqipërisë. Këto rezerva llogariten sa 10% e shumës mesatare të depozitave të muajit për të cilat Banka u detyrohet klientëve, dhe janë si në Lekë ashtu edhe në monedhë të huaj (USD dhe EUR). Mjetet monetare dhe gjendjet me Bankën Qendrore, me përjashtim të arkës, përfshihen në analizën e ekspozimit maksimal ndaj rrezikut të kredisë (shënimi 3.1.4).

Normat e interesit për rezervat e detyrueshme gjatë vitit 2015 dhe 2014, u luhatën si në vijim:

2015			
Monedha	Minimumi	Maksimumi	Metoda e llogaritjes
Lekë	1.225%	1.57%	70% e normës së fitimit të marrëveshjeve të riblerjes
USD	0%	0%	
EUR	0%	0%	

2014			
Monedha	Minimumi	Maksimumi	Metoda e llogaritjes
Lekë	1.575%	2.45%	70% e normës së fitimit të marrëveshjeve të riblerjes
USD	0%	0.00%	
EUR	0%	0.00%	

17. Kredi dhe paradhënie për klientët

Kredi dhe paradhënie për klientët	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Kredi korporate	5,585,719	4,446,827
Kredi SME	9,770,090	11,252,341
Totali kredive korporatë dhe SME	15,355,809	15,699,168
Kredi konsumatore	1,765,296	2,051,804
Hipotekore	257,214	236,585
Paradhënie	43,244	50,955
Karta kredie	36,532	31,063
Interes i përlogaritur	(76,382)	263,509
Komisione të shtyra të kredisë	285,037	(88,150)
Kredi dhe paradhënie bruto	17,666,750	18,244,934
Minus: Provigjion për humbje zhvlerësimi	(1,728,598)	(975,530)
Totali i kredi dhe paradhënie për klientët	15,938,152	17,269,404

Veneto Banka Sh.A.**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare***(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)***17. Kredi dhe paradhënie për klientët (vazhdim)**

Tabela në vijim tregon analizën e kredive bruto të industrisë për klientët korporatë dhe SME.

Kreditë sipas sektorit të industrisë	31 dhjetor 2015	Në % të totalit	31 dhjetor 2014	Në % të totalit
Prodhim	3,279,383	16%	2,876,859	16%
Energji elektrike	1,221,135	9%	1,637,833	9%
Tregtim	3,123,379	16%	2,847,535	16%
Ndëritim	3,488,149	18%	3,350,458	18%
Industri të tjera	4,432,824	28%	5,135,356	28%
Individë	2,121,879	13%	2,396,893	13%
Totali i kredive bruto	17,666,750	100%	18,244,934	100%

Normat e interesit për kreditë dhe paradhëniet ndryshojnë si në vijim:

2015		2014	
Monedha	Norma e Interesit	Monedha	Norma e Interesit
Lekë	Norma fikse 0%-24%	Lekë	Norma fikse 0.2%-15%
Lekë	TB 3M + 3%-15%	Lekë	TB 3M+ 1.1%-15%
Lekë	TB 6M + 3%	Lekë	TB 6M + 3%
Lekë	TB 12M + 4%-6%	Lekë	TB 12M + 4%-6%
USD	Norma fikse 3%-9%	USD	Norma fikse 1.7%-9%
USD	Libor 1M + 3%-6%	USD	Libor 1M + 3%-6%
USD	Libor 3M + 3%	USD	Libor 3M + 3%
EUR	Norma fikse 0%-12%	EUR	Norma fikse 1%-13%
EUR	Euribor 1M + 0%-26%	EUR	Euribor 1M + 0.3%-12.98%
EUR	Euribor 3M + 2%-6.5%	EUR	Euribor 3M + 2%-6.5%

Lëvizja në provigjionin për humbje nga kreditë dhe paradhëniet për klientët është si vijon:

Provigjionin për humbje nga kreditë dhe paradhëniet	2015	2014
Më 1 Janar	975,531	351,960
Shpenzim për vitin	1,189,718	653,619
Kredi të fshira, neto	(436,651)	(30,049)
Më 31 dhjetor	1,728,598	975,530
Të provigjonuara individualisht	1,560,756	846,025
Të provigjonuara në mënyre kolektive	167,842	129,505
	1,728,598	975,530

Lëvizjet në provigjionin për humbje sipas kategorive të kredive gjatë vitit 2015 është si vijon:

2015	Korporatë	SME	Konsumatore	Hipotekore	Karta krediti dhe paradhënie	Totali
Më 1 janar 2015	193,256	718,449	54,086	3,828	5,912	975,531
Shpenzim për vitin	419,197	708,238	53,104	4,308	4,871	1,189,718
Kredi të fshira, neto	-	(434,001)	(2,650)	-	-	(436,651)
Më 31 dhjetor 2015	612,453	992,686	104,540	8,136	10,783	1,728,598

Lëvizjet në provigjionin për humbje sipas kategorive të kredive gjatë vitit 2014 është si vijon:

2014	Korporatë	SME	Konsumatore	Hipotekore	Karta krediti dhe paradhënie	Totali
Më 1 janar 2015	63,845	249,352	38,408	72	283	351,960
Shpenzim për vitin	154,127	469,410	20,082	3,756	6,244	653,619
Kredi të fshira, neto	(24,716)	(313)	(4,404)	-	(616)	(30,049)
Më 31 dhjetor 2014	193,256	718,449	54,086	3,828	5,911	975,530

Veneto Banka Sh.A.**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare***(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)***18 Instrumente financiare të vlefshme për shitje**

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Instrumente financiare të vlefshme për shitje		
Kosto	560,000	2,125,000
Interes i përlogaritur	9,031	26,709
Zbritje e paamortizuar	-	(22,603)
Totali	569,031	2,129,106
Të ardhura të tjera nga rivlerësimi	(95)	2,965
Totali i instrumenteve financiare të vlefshme për shitje	568,936	2,132,071
Afatshkurtër	455,149	1,848,547
Afatgjatë	113,787	283,524

Instrumentet financiare të vlefshme për shitje janë Bono Thesari dhe obligacione në Lekë të Qeverisë Shqiptare. Maturitetet e këtyre Bonove të Thesarit shqiptare janë si vijon:

	Maturiteti	Kosto	Interes i përlogaritur	Zbritje e paamortizuar	Të ardhura të tjera nga rivlerësimi	Vlera kontabël
2015	Deri në 1 muaj	210,000	4,557	-	37	214,594
	1 deri në 3 muaj	210,000	2,718	-	131	212,849
	6 Deri në 12 muaj	140,000	1,756	-	(263)	141,493
		560,000	9,031	-	(95)	568,936
2014	Deri në 6 muaj	1,000,000	12,498	(22,603)	7,661	997,556
	6 deri në 12 muaj	565,000	5,180	-	(882)	569,298
	Deri në 24 muaj	560,000	9,031	-	(3,814)	565,217
		2,125,000	26,709	(22,603)	2,965	2,132,071

Lëvizjet në AFS	2015	2014
Më 1 janar	2,129,106	1,676,276
Blerje gjatë vitit	-	1,136,023
Maturime gjatë vitit	(1,560,075)	(683,193)
Më 31 dhjetor	569,031	2,129,106

19. Instrumente financiare të mbajtura deri në maturim

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Letra financiare të mbajtura deri në maturim		
Kosto	-	10,000
Interes i përlogaritur	-	359
Zbritje e paamortizuar	-	(372)
Totali i instrumenteve financiare të mbajtura deri në maturim	-	9,987
Afatshkurtër	-	9,987
Afatgjatë	-	-

Veneto Banka Sh.A.**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare***(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)***19. Instrumente financiare të mbajtura deri në maturim (vazhdim)**

Maturitetet e këtyre Bonove të Thesarit shqiptare janë si vijon:

	Maturiteti	Kosto	Interes i përlogaritur	Zbritje e paamortizuar	Vlera kontabël
2015	Deri në 1 muaj	-	-	-	-
	1 deri në 6 muaj	-	-	-	-
	6 deri në 12 muaj	-	-	-	-
		-	-	-	-
2014	Deri në 1 muaj	10,000	358	(372)	9,986
	1 deri në 6 muaj	-	-	-	-
	6 deri në 12 muaj	-	-	-	-
		10,000	358	(372)	9,986

Lëvizjet në bonot e thesarit të Qeverisë Shqiptare janë si në vijim:

Lëvizjet në Bono Thesari	2015	2014
Më 1 janar	9,986	73,765
Blerje gjatë vitit	-	9,987
Maturime gjatë vitit	(9,986)	(73,766)
Më 31 dhjetor	-	9,986

20 Aktive afatgjata jomateriale

	Programe Kompjuterike	Liçensë	Total
Në 1 Janar 2014	42,876	31,621	74,497
Shtesa	40,276	611	40,887
Në 31 dhjetor 2014	83,152	32,232	115,384
At 1 January 2015	83,152	32,232	115,384
Shtesa	1,216	597	1,813
Transferime nga në proces/riklasifikime	15,721	-	15,721
At 31 December 2015	100,088	32,829	132,918
Amortizimi			
Në 1 Janar 2014	29,257	23,534	52,791
Amortizimi për vitin financiar	12,302	1,962	14,264
Në 31 dhjetor 2014	41,559	25,496	67,055
Në 1 Janar 2015	41,559	25,496	67,054
Amortizimi për vitin financiar	15,468	2,088	17,556
Në 31 dhjetor 2014	57,027	27,583	84,610
At 1 January 2015	41,559	25,496	67,054
Amortization charge	15,468	2,088	17,556
Disposals	-	-	-
At 31 December 2015	57,027	27,583	84,610
Vlera kontabël neto			
Në 1 Janar 2014	41,593	6,737	48,329
Në 31 dhjetor 2015	43,061	5,246	48,307

Nuk ka aktive të lëna si kolateral nga ana e bankës më 31 dhjetor 2015 (2014: asnjë).

Veneto Banka Sh.A.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur shpjegohet ndryshe)

21 Aktive afatgjata materiale

Kosto:	Mjete transporti	Mobilje dhe të tjera	Komputerike	Përmirësime	Aktive në proces	Totali
Më 1 janar 2014	3,432	222,928	95,202	168,259	35,018	524,839
Shtesa	-	32,020	32,354	23,107	27,187	114,668
Pakësime	-	-	-	23,542	(23,542)	-
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	(4,833)	(7,139)	(11,972)
Më 31 dhjetor 2014	3,432	254,948	127,556	210,075	31,524	627,535
Më 1 janar 2015	3,432	254,948	127,556	210,075	31,524	627,535
Shtesa	-	2,387	8,166	1,124	16,906	28,583
Pakësime	-	6,939	-	5,494	(28,154)	(15,721)
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2015	3,432	264,274	135,722	216,693	20,276	640,397
Zhvlerësimi:						
Më 1 janar 2014	2,852	103,078	56,594	52,280	-	214,804
Zhvlerësimi	290	36,904	22,254	22,641	-	82,089
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2014	3,142	139,982	78,848	74,921	-	296,893
Më 1 janar 2015	3,142	139,982	78,848	74,921	-	296,893
Zhvlerësimi	290	42,595	20,541	23,047	-	86,473
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2015	3,432	182,577	99,389	97,968	-	383,366
VLera kontabel Neto						
Më 31 dhjetor 2014	290	114,966	48,708	135,154	31,524	330,642
Më 31 dhjetor 2015	-	81,697	36,333	118,725	20,276	257,031

Nuk ka aktive të lëna si kolateral nga ana e bankës më 31 dhjetor 2015 (2014: asnjë).

Veneto Banka Sh.A.**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare***(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur shpjegohet ndryshe)***22 Aktive të tjera**

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Instrumente të tjera financiare		
Debitorë të tjerë	49,732	50,298
Të arkëtueshme për kartat Visa	12,425	7,620
Totali i aktiveve të tjera financiare	62,157	57,918
 Kolaterale të riposeduara	1,587,972	847,162
Shpenzime të parapaguara	24,776	26,996
Aktive të tjera	96,153	61,774
Totali i aktiveve të tjera	1,771,058	993,850

Më 31 dhjetor 2015 kolateral i riposeduar i Bankës është 1,587,972 mijë Lekë (2014: 847,162 mijë Lekë). Kolateral i riposeduar përfaqëson aktivet e pasurive të patundshme të rimarra nga Banka në shlyerjen e kredive në vonesë. Aktivet nuk plotësojnë përkufizimin e aktiveve afatgjatë të mbajtur për shitje, dhe janë klasifikuar si inventarët në përputhje me SNK 2 "Inventarët". Aktivet janë njohur fillimisht me vlerën e drejtë në momentin e blerjes.

23 Detyrime ndaj bankave

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Llogari rrjedhëse		
Rezidentë	185	42
	185	42
Hua		
Rezidentë	-	-
Jorezidentë	1,510,080	700,700
	1,510,080	707,700
Interes i përlogaritur	7,433	1,138
Totali i detyrimeve ndaj bankave	1,517,698	701,880
Afatshkurtër	185	42
Afatgjatë	1,517,513	701,838

Gjatë 2015, banka mori hua 11 milion Euro nga Veneto Banca Scpa, duke zëvendësuar linjën e kredisë me BERZH. Huaja është dhënë në katër linja, për një total prej 21.8 milion Euro. Interesi paguhet në periudha 6-mujore. Interesi i përlogaritur me bankat jorezidente për 2015 është 7,433 mijë Lekë (2014: 1,138 mijë Lekë).

24 Detyrime ndaj klientëve

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Korporatat		
Llogari rrjedhëse	3,132,342	4,325,636
Depozita me afat	1,823,345	1,543,780
Depozita të tjera	37,915	259,960
	4,993,602	6,129,376
Individë		
Llogari rrjedhëse/kursimi	1,474,242	1,301,967
Depozita me afat	14,063,794	14,151,293
Depozita të tjera	574,739	14,648
	16,112,775	15,467,908
Interes i përlogaritur	230,260	332,410
Total detyrime ndaj klientëve	21,336,637	21,929,694

Veneto Banka Sh.A.**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare***(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur shpjegohet ndryshe)***25 Detyrime ndaj klientëve (vazhdim)**

Një shumë prej 1,419,035 mijë Lekë (2014: 2,527,260 mijë Lekë) është përfshirë si depozitë e mbajtur si kolateral për angazhime të pakthyeshme. Depozitat me klientët mbartin interes të pandryshueshëm.

Dhjetë depozitat më të mëdha arritën 3,006,536 mijë ose 14% të totalit të llogarive të klientëve, si në 31 dhjetor 2015 (2014: Lek 3,063,331 ose 14% e totalit të llogarive të klientëve).

26 Detyrime të tjera

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Pagesa pezull	48,471	94,139
Shpenzime të përlogaritura	68,688	64,364
Detyrime të tjera	71,492	39,610
Tatime të tjera të tjera për t'u paguar	9,400	430
Sigurime shoqërore për t'u paguar	3,907	6,953
Totali detyrime të tjera	201,959	205,496

Shpenzimet e përlogaritura përfshijnë shpenzime mbi shërbime bazë dhe shpenzime telefoni, të cilat lidhen me vitin aktual por që do të paguhen vitin në vazhdim.

27 Kapitali aksionar dhe primi i aksioneve

<i>Shumat në EUR</i>	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Kapitali aksionar i autorizuar, i emetuar dhe i paguar plotësisht	34,542,750	34,542,750
Primi i aksioneve	566,000	566,000
<i>Shumat në mijë Lekë</i>	2015	2014
Kapitali aksionar i autorizuar, i emetuar dhe i paguar plotësisht	4,661,307	4,661,307
Primi i aksioneve	70,069	70,069

Banka mëmë e drejtpërdrejtë është Veneto Banca Scpa, Itali.

Tabela në vijim tregon strukturën e aksionarëve të bankës më 31 dhjetor 2015 dhe 2014:

Emri i aksionarit	2015		2014	
	Numri i aksioneve	Aksionet në %	Numri i aksioneve	Aksionet në %
Veneto Banca S.c.p.a Italy	4,345	100%	4,345	100%
Totali	4,345		4,345	

Më 31 dhjetor 2015, kapitali aksionar i bankës i autorizuar dhe i emetuar përbëhej nga 4,345 aksione me vlerë nominale 7,950 Euro (2014: 4,345 aksione me vlerë nominale 7,950 Euro) të gjitha të paguara.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur shpjegohet ndryshe)

28 Rezerva të tjera

Rezerva të tjera përbëhen si më poshtë:

	Rezerva ligjore	2015 Rezerva për letrat me vlerë AFS	Totali i rezervës	Rezerva ligjore	2014 Rezerva për letrat me vlerë AFS	Totali i rezervës
Më 1 janar	19,358	-	19,358	19,358	-	19,358
Rivlerësimi i instrumenteve financiare të vlefshme për shitje	-	(95)	(95)	-	2,965	2,965
Tatimi i shtyrë mbi rivlerësimin e instrumenteve financiare të vlefshme për shitje	-	14	14	-	445	445
Më 31 dhjetor	19,358	(81)	19,277	19,358	2,521	21,879

Rezerva ligjore është përcaktuar në bazë të rregullores së Bankës së Shqipërisë "Për kapitalin fillestar minimal për aktivitetet e lejuara të bankave dhe degëve të licencuara të bankave të huaja", nr. 51, datë 22 prill 1999. Bankat dhe degët e bankave të huaja do të krijojnë rezerva nga 1.25% deri në 2% të aktiveve të ponderuara me rrezik duke zbritur 1/5 e fitimit pas tatimit dhe para se të paguhet dividendët. Rezerva e detyruar është përcaktuar në bazë të nenit 39 të statutit të bankës i cili kërkon krijimin e rezervave duke mbajtur 5% të të ardhurave neto të bankës pas zbritjes së humbjeve të viteve të mëparshëm. Kjo procedurë nuk është e detyruar nëse rezerva arrin 1/10 e kapitalit të bankës. Rezervat ligjore dhe të detyruara nuk mund të shpërndahen.

29 Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre

Për qëllim të pasqyrës së flukseve monetare, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përbëhen si në vijim:

Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Arka	320,791	342,860
Llogari me Bankën Qendrore	95,414	26,059
Llogari rrjedhëse me bankat	2,810,371	2,664,817
Kredi dhe paradhënie për bankat	2,249,120	1,170,231
Totali mjeteve monetare dhe ekuivalentët e tyre	5,475,696	4,203,967

Veneto Banka Sh.A.**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare***(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur shpjegohet ndryshe)***30 Prezantimi i instrumentave financiarë sipas kategorisë së matjes**

Tabela e mëposhtme paraqet rakordimin sipas klasave të aktiveve financiare me kategoritë e matjes më 31 dhjetor 2015:

31 dhjetor 2015	Hua dhe Llogari të Arkëtueshme	Instrumente financiare të mbajtura deri në maturim	Instrumente financiare të vlefshme për shitje	Totali
Mjete monetare dhe Banka Qendore	5,475,696	-	-	5,475,696
Rezerva e detyrueshme	1,979,069	-	-	1,979,069
Instrumente financiare të mbajtura deri në maturim	-	-	-	-
Instrumente financiare të vlefshme për shitje	-	-	568,936	568,936
Hua dhe Paradhënie për Klientët	15,938,152	-	-	15,938,152
Aktive të tjera financiare	62,157	-	-	62,157
Totali i Aktiveve Financiare	23,455,075	-	568,936	24,024,011
Aktive të tjera	2,063,465	-	-	2,063,465
Totali i Aktiveve				26,087,476

31 dhjetor 2014	Hua dhe Llogari të Arkëtueshme	Instrumente financiare të mbajtura deri në maturim	Instrumente financiare të vlefshme për shitje	Totali
Mjete monetare dhe Banka Qendore	4,203,967	-	-	4,203,967
Rezerva e detyrueshme	1,883,999	-	-	1,883,999
Instrumente financiare të mbajtura deri në maturim	-	9,987	-	9,987
Instrumente financiare të vlefshme për shitje	-	-	2,132,071	2,132,071
Hua dhe Paradhënie për Klientët	17,269,404	-	-	17,269,404
Aktive të tjera financiare	57,918	-	-	57,918
Totali i Aktiveve Financiare	23,415,288	9,987	2,132,071	25,557,346
Aktive të tjera	1,352,553	-	-	1,352,553
Totali i Aktiveve				26,909,899

Më 31 dhjetor 2015 dhe 2014, kreditë dhe llogaritë e arkëtueshme dhe aktivet financiare të mbajtura deri në maturim maten me kosto të amortizuar. Më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 të gjitha detyrimet financiare të bankës janë mbajtur me kosto të amortizuar.

31 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Politika e bankës është që ajo të ketë kontrata afatgjata, të cilat variojnë nga 1 deri në 9 vjet. Kontratat rinovohen nëpërmjet negociatave midis të dyja palëve në mënyrë që të bihet dakord për kushte të reja për kontratat. Marrëveshjet e qirasë operative janë në Euro. Pagesat minimale të qirasë në mijë Lekë sipas marrëveshjeve të paanullueshme të qirasë operative janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Jo më shumë se 1 vit	112,643	113,793
Më shumë se 1 vit dhe më pak se 5 vjet	306,723	428,694
Më shumë se 5 vjet	9,978	14,324
	429,344	556,811

31 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara (vazhdim)**Çështje ligjore**

Nga koha në kohë dhe në rrjedhën normale të biznesit, padi kundër Bankës mund të ngrihen. Në bazë të vlerësimeve të veta dhe këshillave të brendshëm dhe të jashtme profesionale, menaxhimi është i mendimit se nuk ka humbje materiale që do të lindin në lidhje me pretendimet, dhe për më tepër këto pretendime nuk do të kenë impakt në Pasqyrat Financiare të vitit të mbyllur 2015.

Legjislacioni tatimor

Legjislacioni tatimor në Shqipëri është subjekt i interpretimeve të ndryshme dhe ndryshimeve të shpeshta. Interpretimi i këtij lloji legjislacioni nga menaxhimi aplikohet tek transaksionet dhe aktiviteti i Shoqërisë, por mund të kundërshtohet nga autoritetet përkatëse.

Organet tatimore shqiptare mund të mbajnë një qëndrim më të ngushtë dhe të ndryshëm në interpretimin e tyre të legjislacionit si dhe gjatë kontrolleve tatimore. Kombinuar kjo me një rritje të mundshme të mbledhjes së taksave si përgjigje e presionit të buxhetit, do të shkaktojë rritje të nivelit dhe shpeshtësinë e kontrolleve tatimore. Në veçanti, është e mundur që transaksionet dhe aktivitetet që nuk janë diskutuar më parë të bëhen objekt diskutimi dhe kundërshtimi në vitet në vijim. Kjo mund të sjellë pagesën e detyrimeve tatimore shtesë përfshirë gjoba dhe kamatevonesa. Organet tatimore kanë të drejtë të kontrollojnë deri në pesë vite mbropa.

32 Palët e lidhura

Gjatë kryerjes së biznesit bankar, Banka kryen transaksione me palët e lidhura. Palët e lidhura përfshijnë (a) Veneto Banca Scpa për llogari rrjedhëse, vendosje ndërbankare dhe huamarrje.

Pala kontrolluese përfundimtare e Bankës është Veneto Banca Scpa.

Palët e lidhura	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Aktivitet		
Veneto Banca Scpa, Itali		
Depozita	1,099,190	514,850
	1,099,190	514,850
Liabilities		
Veneto Banca Scpa, Itali		
Due to	1,517,513	-
	1,517,513	-

Palët e lidhura	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Personeli kyç i manaxhimit		
Kredi të dhëna	4,229	9,860
Depozita	19,930	16,953
	15,701	7,093

Normat e interesit e aplikuar ndaj depozitave me Veneto Banka S.c.p.a për vitin 2015 dhe 2014 ndryshojnë si vijon:

2015 interesi në EUR ka ndryshuar nga 0.238% - 0.059% (2014: 0.21% - 0.406%)

2015 interesi në USD ka ndryshuar nga 0.381% - 0.463% (2014: 0.271% - 0.344%)

Veneto Banka Sh.A.**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare***(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur shpjegohet ndryshe)***32 Palët e lidhura**

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Të ardhura dhe shpenzime		
Veneto Banca Scpa, Itali		
Të ardhura nga interesi	697	1,700
Shpenzime interesi	29,875	-
	30,572	1,700
Personeli Manaxherial		
Të ardhura nga interesi	159	264
Shpenzime të tjera	(193)	(484)
Komisione	8	13
	(26)	(207)
Përfitime afatshkurtra		
Paga	(48,058)	(66,211)
	(48,058)	(66,211)

Në shpërblimet e menaxhimit kyç përfshihen vetëm përfitimet afatshkurtra të punonjësve, pagat. Banka nuk aplikon përfitimet pas punësimit, pagesat e bazuara në aksione dhe përfitimet afatgjata.

33 Ngjarje pas datës së Raportimit

Më 29 qershor 2016, Bordi i Drejtorëve të Shoqërisë mëmë ka aprovoi një rritje të kapitalit në vlerën maksimale prej 30,003 mijë Euro (ekuivalente në Lekë 412,353 mijë konvertuar më kursin e këmbimit Euro/Lekë 137.19) për Veneto Banka sh.a. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve pritet të ratifikojë vendimin e Bordit të Drejtorëve deri më 07 korrik 2016. Fondet priten të depozitohen në llogarinë e Bankës brenda muajit korrik 2016.

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së Bilancit të cilat kërkojnë rregullime të pasqyrave apo shënimeve shpjeguese.